



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Raport
CSR

2017

Bankat për
shoqërinë



SË BASHKU PËR
SHOQËRINË, NJERËZIT,
MJEDISIN JETËN

BANKAT PËR SHOQERINË



PARATHËNIE

Për të katërtin vit radhazi, Shoqata Shqiptare e Bankave ka kënaqësinë t'ju ofrojë një këndvështrim më të plotë lidhur me arritjet në këtë sektor dhe progresin e shënuar në fushën e qëndrueshmërisë gjatë vitit që lamë pas. 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ-të) na ofrojnë një kuadër për zhvillimin e qëndrueshëm. Kemi ende shumë sfida për t'u përballur dhe shumë punë për të bërë, por ndihem shumë krenar për atë që kemi arritur deri më tani dhe ndikimin pozitiv që po shënojmë.

Nëse i kthehemi sërish vitit 2017, përfshirja e OZHQ-ve në rrënjët e biznesit dhe në ciklin e raportimit u ka dhënë mundësinë bankave që të përqendrohen në kristalizimin e vlerave të dukshme të përbashkëta. Ky angazhim për përfshirje efektive kërkon shumë kohë, sinergji dhe vullnet të mirë. Mund të përmendim disa shembuj se si bankat po marrin pjesë në krijimin e pasurisë, hapjen e vendeve të punës, zhvillimin e punonjësve, përmirësimin e rregulloreve dhe sigurimin e mundësive të barabarta.

Raporti pasqyron qartë se bankat në përgjithësi mbështesin pothuajse të 17-të objektivat, por ato për shëndetin dhe mirëqenien, arsimin cilësor, inovacionin dhe infrastrukturën, si dhe për komunitete dhe qytete të qëndrueshme janë ato që kanë tërhequr më shumë vëmendje nga pikëpamja e financimit. Për t'i bërë më konkrete këto veprimtari përmes shifrave, vërejmë se kontributi i sektorit bankar në shoqëri gjatë vitit 2017 ariti në vlerën 1,200,000 euro. Përveç kësaj, kontributi ynë ka bërë të mundur që shumë njerëz të kenë akses në produktet e energjisë, investime në teknologji miqësore ndaj mjedisit, financime për bujqësi të qëndrueshme, produkte kredie për t'u ardhur në ndihmë familjeve të planifikojnë dhe financojnë kostot e arsimimit, programe që mbështesin gratë në tregun e punës, mbështetje për nisma dhe ide inovatore, përmirësimi i kushteve dhe zhvillimi i ideve të reja.

Dhe jo vetëm kaq. Sponsorizimet dhe donacionet e ndryshme vazhdojnë të mbeten pjesë e përgjegjësisë sociale të korporatave, sidomos në fushën e kulturës, artit dhe sportit. Përgjegjësia sociale korporative, së bashku me veprimtarinë bankare, janë dy shina që ecin paralelisht, por në këtë botim ju kemi paraqitur përgjegjësinë sociale të korporatave nga një këndvështrim i veçantë. Më shumë vizibilitet, më pranë komunitetit, më shumë përgjegjësi! Bankat janë pjesë e shoqërisë dhe ekonomisë. Dhe roli i tyre në të dyja është i ndjeshëm, i dukshëm dhe i vlerësueshëm.



Veç kësaj, bankat e shikojnë të dobishme komunikimin me anë të OZHQ-ve dhe po përdorin botimet, faqet e internetit ose mediat sociale në mënyrë që të përcjellin ecurinë e tyre në lidhje me OZHQ-të.

Bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, duke zbatuar OZHQ-të, do të parashtrojë nevojën për zhvillimin e formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Tëksa hedhim vështrimin drejt objektivave të qëndrueshëm, mbetemi të përkushtuar për të ofruar rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë dhe ndikime afatgjata sociale dhe mjedisore në të gjithë vendin. Bankat anëtare të AAB-së janë gjithmonë të gatshme të punojnë me të gjitha institucionet për t'i bërë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të prekshme për të gjithë.

Me besimin se ky botim është një vlerë e shtuar e përvojës tashmë të fituar në këtë fushë dhe se ju do ta gjeni atë të vlefshëm, ju uroj lexim të këndshëm!

Me përzemërsi,

Silvio Pedrazzi

Kryetar

Shoqata Shqiptare e Bankave

Përmbajtja

OBJEKTIVI 1	Pa Varfëri	6
OBJEKTIVI 2	Zero Uri	9
OBJEKTIVI 3	Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie	12
OBJEKTIVI 4	Arsim Cilësor	15
OBJEKTIVI 5	Barazi Gjinore	21
OBJEKTIVI 7	Energji e Përballueshme	22
OBJEKTIVI 8	Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike	23
OBJEKTIVI 9	Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë	28
OBJEKTIVI 10	Zvogëlim i Pabarazive	31
OBJEKTIVI 11	Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	33
OBJEKTIVI 12	Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm	36
OBJEKTIVI 13	Veprim për Klimën	37
OBJEKTIVI 15	Jeta në Stere	39
OBJEKTIVI 16	Paqe dhe Drejtësi, Institucione të Forta	40
OBJEKTIVI 17	Partneritet për Objektivat	41
ART, SPORT & KULTURË		46
ÇMIME		49

1 PA VARFËRI



19,000 €

2 ZERO URI



26,000 €

3 SHËNDETI I MIRË DHE MIRËQËNIE



149,000 €

4 ARSIM CILËSOR



371,000 €

5 BARAZI GJINORE



10,000 €

7 ENERGJI E PËRBALLUESHME



8 PUNË DINJITOZE DHE RRIJTJE EKONOMIKE



91,000 €

9 INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË



122,000 €

10 ZVOGËLIM I PABARAZIVE



25,000 €

11 QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME



161,000 €

12 KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM



250 €

13 VEPRIM PËR KLIMËN



6,300 €

15 JETA NË STERE



11,000 €

16 PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



4,000 €

17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT



53,000 €

ART SPORT & KULTURË

120,000 €

OBJEKTIVI #1 Pa Varfëri

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Ofron inovacione për zhvillimin e produkteve të reja bankare, metodologjitë për vlerësimin e kredive, modellet e operimit dhe kanalet e shpërndarjes (duke përfshirë mobile banking) për përmirësimin e përfshirjes financiare, duke përfshirë edhe bankë për 2.5 miliard të rritur që aktualisht nuk disponojnë llogari bankare dhe mikro-sigurimin për rritjen e mbrojtjes sociale.

Siguron për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfërit dhe personat e cenueshëm, që të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe akses në shërbimet bazë, të gëzojnë pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimisë, burimeve natyrore, teknologjive të reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë edhe mikro-financën.




PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Dhurimi i çantave të shkollës – Bashkëpunim me organizatën “Fundjavë Ndryshe”

nga Alpha Bank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Tirana Bank

Në bashkëpunim me këtë organizatë, bankat u bënë pjesë e projektit për t'u dhuruar çanta shkolle dhe mjete mësimore fëmijëve të familjeve në nevojë.



Përfshirja në Festën e Fëmijëve

nga Alpha Bank Albania, Banka Amerikane e Investimeve, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Tirana Bank

Bankat ofruan mbështetje për organizatat dhe morën pjesë në projekte që mbështesin të drejtat e fëmijëve, dhe punuan për përmirësimin e jetëve të tyre. Disa nga veprimtaritë e organizuara më 1 qershor të mbështetura nga bankat:

- ◆ **Alpha Bank Albania** mbështeti “Paradën dhe festivalin e fëmijëve” në Festën e Fëmijëve në qytetin e Vlorës.
- ◆ Punonjësit e **Bankës Amerikane të Investimeve** iu bashkuan nismës vullnetare për të blerë lodra për fëmijët e familjeve në nevojë.





- ◆ Nën moton “Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të festojnë!” në Festën e Fëmijëve, stafi i **Intesa Sanpaolo Bank Albania** kontribuoi me veshmbathje dhe lodra për fëmijët jetim, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.
- ◆ **Tirana Bank** festoi me fëmijët e Down Syndrome Albania dhe ofroi mbështetje për organizimin e pjesës teatrale “Një vonesë e vogël”.

Shtëpia e të moshuarve

nga Alpha Bank Albania, Soci t  G n rale Albania



Punonj sit e bankave kontribuuan vullnetarisht p r t  mbledhur artikuj t  ndrysh m personal  dhe ushqimor , t  cil t iu dhuruan t  moshuarve dhe gjithashtu kaluan disa or  n  ambientet e sht piss  s  t  moshuarve.

Ofrimi i kujdesit dhe mb shtetjes p r f mij t jetim

nga Banka Amerikane e Investimeve, Banka Komb tare Tregtare, Banka Credins, Banka Soci t  G n rale Albania, Union Bank



- ◆ M  21 dhjetor, **Banka Amerikane e Investimeve** festoi Dit n e Vitit t  Ri bashk  me f mij t e Spitalit Pediatrik n  Tiran , ku u dhuruan m  shum  se 200 lodra dhe dhurata t  ndryshme, t  mbledhura vullnetarisht nga stafi i bank s.
- ◆ **Banka Komb tare Tregtare** bashk  me stafin e saj, me rastin e fushat s “Mb shtetje dhe Asistenc  p r F mij t Jetim  n  Komunitet”, grumbulluan ushqime, veshje dhe lodra p r k ta f mij . Kjo nism  erdhi n  mb shtetje t  fushat s s  Kryqit t  Kuq Shqiptar.
- ◆ N n moton “Stafi i Credins dhuron ngroht si”, **Banka Credins** vazhdoi kontributin p r komunitetin. Gjat  muajit Dhjetor, pas n j fushate t  brendshme me n j Llogari Solidariteti, stafi vendosi t  blej  ngroh se dhe batanije p r dimrin e ftoht  p r familjet n  zonat e p rmbytura. Stafi u organizua n  skuadra p r shp rndarjen e tyre n   do familje, n  bashk punim me autoritetet vendore p r t  identifikuar njer zit n  nevoj . N  Fush  Kruj  u ndihmuan 40 familje. Gjithashtu, kjo mb shtetje u organizua edhe n  qytet e Vlor s dhe Fierit.
- ◆ “Nj  dit  me f mij t jetim ” ishte nj  nism  e mb shtetur nga banka **Soci t  G n rale Albania**.




- ◆ Me rastin e fund vitit, stafi i zyrës qendrore të **Union Bank** u sensibilizua dhe grumbulloi lodra, të cilat iu dhuruan fëmijëve të shtëpisë së fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë.



Përmirësimi i situatës për njerëzit që jetojnë në varfëri ekstreme

Nga Banka Société Générale Albania dhe Union Bank

- ◆ Banka **Société Générale Albania** dhuroi donacione për dy familje në varfëri ekstreme. Gjithashtu, ajo ndërtoi një çati për shtëpinë e njëjës prej këtyre familjeve.
- ◆ Stafi i **Union Bank**, nëpërmjet një kontributi vullnetar, kontribuoi për të rinovuar shtëpinë e familjes Rapush në Elbasan, e cila jetonte në varfëri ekstreme.



OBJEKTIVI #2 Zero Uri

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet financiare për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme.

Bashkëpunim me shoqëri të tjera, Qeverinë dhe shoqërinë civile për identifikimin e mundësive të reja të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të biznesit (p.sh. financimi i farës dhe risive në mikroushqyerje).

Sigurimi i aksesit për të gjithë njerëzit, në veçanti për të varfrit dhe njerëzit në situata të cënueshme, duke përfshirë edhe foshnjat, në ushqime të sigurta, ushqyese dhe të mjaftueshme gjatë gjithë vitit.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Dikush ka shkruar një kartolinë për ty!

nga Banka Ndërkombëtare Tregtare, Procredit Bank, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Punonjësit e Bankës mbështetën nismën e fshatit SOS, duke blerë kartolina bamirësie të përgatitura nga fëmijët e këtij fshati. Çdo vit, fshati SOS organizohet fushata për shitjen e kartolinave për të mbledhur më shumë fonde për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve të këtij fshati.

Bujqësi e qëndrueshme dhe zhvillim rural

nga Alpha Bank Albania, Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen Bank, Banka Societe Generale Albania, Procredit Bank dhe Tirana Bank

- ◆ **Alpha Bank Albania, Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank** mbështetën edicionin e parë të Panairit 'Shqipëria kultivon tokën' të organizuar nga Kryeministri i Shqipërisë dhe Ministria e Bujqësisë, i cili pati në fokus promovimin e produkteve shqiptare.

- ◆ **Banka Credins** mori pjesë në Konferencën Kombëtare të Bujqësisë të organizuar më 11 dhjetor. Banka Credins lehtësoi qasjen e fermerëve në financa, bashkëpunoi me institucione jo-bankë dhe me qeverinë për të lehtësuar



dhënien e huave dhe qasjen në grantet bujqësore.




- ◆ **Procredit Bank** vazhdoi të mbështesë agrobiznesin shqiptar në kuadër të Fasilitetit të mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar, e iniciuar nga BERZH dhe qeveria e Shqipërisë. Kjo lehtësi është një produkt novator që do t'i japë mundësinë Bankës të zgjerojë gamën e kredive për agrobiznesin shqiptar, duke mbështetur financimin dhe duke u ofruar zhvillim të qëndrueshëm, duke përmirësuar mënyrat për të pasur qasje në financat për agrobiznesin lokal nëpërmjet linjave të dedikuara të kredive ose duke ndarë mes tyre riskun e kredive me sektorin e agrobiznesit.
- ◆ **Raiffeisen Bank** mbështeti aktivitetin “Misioni i Ekonomisë Bujqësore në Shqipëri”, i organizuar nga Advantage Austria Albania.
- ◆ Nëpërmjet bashkëpunimit me BERZH-in, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** ia doli të prezantojë instrumentet e reja për menaxhimin e riskut, të cilat jo vetëm ndihmuan për të rritur huadhënien dhe për të ulur koston e rreziqeve, por gjithashtu ndihmuan për të përmirësuar qasjen ndaj huadhënies në këtë sektor të rëndësishëm të biznesit. Marrëveshja me BERZH-in do të rrisë edhe më tepër zhvillimin e financimit të qëndrueshëm në sektorin bujqësor, duke ofruar një linjë të zbatueshme dhe të vazhdueshme të kredive të biznesit për këtë sektor të veçantë ku jemi fokusuar gjatë këtyre tre viteve të fundit.
- ◆ Banka **Société Générale Albania** organizoi seminarin me temë “Mbështetja e Agrobiznesit në Shqipëri”. Në kuadër të projektit nisur në dhjetor të vitit 2016, ku Société Générale Albania (SGAL) dhe BERZH-i bashkuan forcat nën Fasilitetin e mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) për të rritur qasjen e fermerëve vendas dhe shoqërive të agrobiznesit në financime, veçanërisht në zonat e thella të vendit.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Donacione për familjet që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme dhe për grupet e cenueshme

nga Banka Amerikane e Investimeve, Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen Bank



- ◆ **Banka Amerikane e Investimeve** festoi Ditën e Falënderimeve me personat në nevojë në Qendrën Sociale nr. 6 në Tiranë. Stafi i ABI Bank, bashkë me përfaqësuesit e Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe me Këshillin Rinor të Ambasadës Amerikane, u njohën nga afër me problematikat dhe nevojat që kishte kjo qendër dhe diskutuan mundësitë për mbështetje të mëtejshme nga komuniteti i biznesit.

- ◆ Degët e **Bankës Credins** në qytetin e Fierit u organizuan vullnetarisht për t'i dhuruar veshje dhe ushqime Kryqit të Kuq Shqiptar, shoqatës humanitare më të vjetër në Shqipëri. Banka bashkëpunon rregullisht me organizata dhe projekte të ndryshme që ndihmojnë në zhdukjen e varfërisë për grupet e cenueshme të të rriturve dhe për fëmijët pa përkujdesje prindërore.

- ◆ Gjatë muajit prill, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** bashkëpunoi me Bankën Shqiptare të Ushqimit për të mbështetur njerëzit që jetojnë në kushte shumë të vështira, të cilët nuk mund as të përballojnë të blejnë ushqime. Brenda dy javësh, punonjësit e zyrës qendrore të ISBA-së mblodhën rreth 115 kg ushqime, të cilat u dërguan në një kantinë sociale që ofron ushqim për 200 persona deri në 3 herë në javë.

- ◆ Gjatë fundjavës së 2 dhe 3 dhjetorit, 112 punonjës nga **Intesa Sanpaolo Bank Albania** (përfshirë edhe z. Pedrazzi, Drejtor Ekzekutiv i Bankës) dolën vullnetarë për të mbledhur ushqime për të mbështetur njerëzit që jetojnë në kushte shumë të vështira, në luftën kundër varfërisë ekstreme dhe urisë. Kjo nismë u organizua për herë të parë në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë në shtatë qytete të mëdha të vendit, si një bashkëpunim i trefishtë ndërmjet Bankës Shqiptare të Ushqimeve, rrjetit të supermar-

keteve CONAD dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania. Vlen të përmendet fakti se stafi i degëve jashtë kryeqytetit, si në Vlorë (të dy degët), Shkodër, Elbasan, Lushnje, Fier dhe Korçë, duruan një shkallë angazhimi 100%. E gjithë veprimtaria u organizua sipas përvojës shumë të suksesshme “Giornata Nazionale della Colleta Alimentare” në Itali dhe në bazë të një përvoje të përkushtuar të z. Marco Lucchini i cili vizitoi Intesa Sanpaolo Bank Albania gjatë muajit shtator. Banka Shqiptare e Ushqimeve është një organizatë jo-fitimprurëse që bashkëpunon ngushtësisht me Federatën Evropiane të Bankave të Ushqimit (FEBA). Shpirti i skuadrës dhe solidariteti që treguan 112 vullnetarët nga Intesa Sanpaolo Bank ishte me të vërtetë mbresëlënëse! U realizua një punë e mrekullueshme: u mblodhën 3,700 kg ushqime!

- ◆ Në fund të vitit, **Raiffeisen Bank** ofroi mbështetje për Shoqatën e Pensionistëve. Mbi 400 shporta me ushqime bazë iu shpërndanë pensionistëve në varfëri ekstreme.

OBJEKTIVI #3 Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Sigurimi dhe/ose mbledhja e fondeve për investime për institucionet shëndetësore.

Shqyrtimi i hartimi të politikave që përfshijnë shërbime të parasë së lëvizshme për transferimin efikas të fondeve me qëllim mbulimin e kostove shtesë që lidhen me aksesin në kujdesin shëndetësor shtetëror.

Vendosja e një bashkëpunimi me ofruesit e telefonisë celulare dhe organizatat komunitare për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë shëndetin, duke reduktuar numrin e kredive të papaguara dhe kërkesat për sigurim që lindin nga çështjet shëndetësore.

Mbështetje ndaj punonjësve, familjeve, komuniteteve dhe kombeve të shëndetshme, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurta pune.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Promovimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për shëndetin dhe mirëqenien

nga Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve, FIBank Albania, Banka Societe Generale Albania

Banka Credins mbështeti Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale në veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit. Banka u bë pjesë e një sërë aktiviteteve, për të dhënë informacion dhe për të kryer ekzaminime në të gjithë vendin, përfshirë këtu edhe aktivitete të tilla si shitja e buqetave me lule te Pazari i Ri më 15 tetor, në Sheshin Kreativ të Tiranës. Ky aktivitet synonte të mbledhte fonde dhe të investonte për të blerë pajisje për diagnostikimin e kancerit të gjirit, për të bërë të mundur parandalimin e kancerit në kohë.

Duke blerë një nga produktet ose shërbimet e bankës, të gjithë klientët e Bankës Credins përfitojnë Sigurimin e Jetës dhe Sigurimin nga Aksidentet në Rrjetin Mjekësor SiCRED. Gjatë vitit 2017, kjo nismë përfshiu dy segmente: Studentët dhe Pensionistët.






Banka Amerikane e Investimeve iu bashkua fushatës “Së bashku kundër kancerit të gjirit – Burra mbështetni fushatën rozë” të prezantuar nga Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare për të nëntin vit radhazi. Ministrja e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, Ambasadorja e BE-së në Tiranë, znj. Romana Vlahutin, Ambasadori i SHBA-së, David Munz, Kryetari i Bashkisë Lezhë, Fran Frrokaj, dhe shumë personalitete të tjera dhe punonjës të bankës morën pjesë në një marshim simbolik për t’iu bashkuar kauzës që përfaqësonin.



FIBank Albania e festoi ndryshe 1 qershorin! Fushata e sensibilizimit “Ti je një luledielli”, u kthye shpejt në një përfshirje të vërtetë sociale ku shumë njerëz blenë bluzat me luledielli për të mbështetur Spitalin Shtetëror Pediatrik, dhe në mënyrë më specifike Departamentin e Onkologjisë. Duke mbuluar shpenzimet e prodhimit të bluzave, FIBank bashkë me disa shoqëri të tjera që u bënë pjesë e kësaj nisme, mundësuan inaugurimin e pajisjeve më të fundit teknologjike në pavilionin e onkologjisë në Spitalin Pediatrik. Mbledhja e këtyre fondeve është një projekt në vazhdim e sipër, derisa të mbulojë të gjithë spitalet në qytetet e tjera të Shqipërisë.



Banka **Société Générale Albania:**

- ◆ Mbështeti fëmijët e diagnostikuar me diabet Mellitus (tipi 1).
- ◆ Dega në Gjirokastrë, në kuadër të nismës “Fundjavë Ndryshe” organizoi një aktivitet jo-fitimprurës për të mbledhur fonde për fëmijët autikë. Fondet e mbledhura iu dhuruan Qendrës së Autizmit, e cila kishte nevojë urgjente për pajisje mësimore.



Investimi në institucione shëndetësore

nga Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins, Raiffeisen Bank

- ◆ **Banka Kombëtare Tregtare** ofroi mbështetje financiare për maternitetin “Mbretëresha Geraldinë” për të blerë një aparaturë Convex me ultratinguj. Për më tepër, banka vazhdon bashkëpunimin afatgjatë me Spitalin “Xhafer Kongoli”, duke ofruar mbështetje për blerjen e 2 (dy) pajisjeve ESR me detektorë të shpejtë për matjen e sedimentit të eritrociteve.

- ◆ **Banka Credins** mbështeti:

“Fondacionin Fëmijët Shqiptarë”, duke ofruar mbështetje financiare për Qendrën për Zhvillimin e Fëmijëve me Probleme Autike.

Këto nisma synonin të përmirësonin kushtet fizike (rikonstrukcioni dhe restaurimi i mjediseve të jashtme dhe të



brendshme) për institucionet e sistemit shëndetësor dhe institucionet e tjera të administratës publike, si: Spitali Rajonal Shkodër, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Qendra Spitalore Universitare Tiranë, Qendra Shëndetësore nr. 9.

◆ **Raiffeisen Bank** mbështeti:

TISS-in, Qendrën e Shërbimeve dhe Trajtimit Psikosocial. Banka kontribuoi në ndërtimin e dhomës për vlerësimin e zhvillimit të aftësive kognitive, komunikuese dhe funksionale të fëmijëve, e cila ishte tejet e nevojshme për TISS-in. Kjo dhomë do të përdoret për të zhvilluar procesin e para-vlerësimit për fëmijët që vizitojnë këtë qendër dhe gjithashtu për të zhvilluar intervista paraprake me prindërit e fëmijëve.

Ngritjen e një qendre të re në qytetin e Durrësit.

Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) në projektin e saj të madh për rehabilitimin e pavijonit të reanimimit kardio-pulmonar. Ky projekt synon të ofrojë trajtim cilësor për pacientët që kanë nevojë për reanimim kardio-pulmonar në QSUT.

Fondacionin Spitalor të Nënës dhe Fëmijës. Me mbështetjen e bankës, fondacioni organizoi forume dhe seminare për sistemet e vlerësimit dhe referimit për të porsalindurit.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Maratona e Tiranës

nga Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Raiffeisen Bank

Këtë vit, edicioni i dytë i Maratonës së Tiranës u konsiderua si ngjarja më e rëndësishme në qytet. Shumë banka e mbështeti këtë nismë për të arritur objektivin dhe qëllimin e saj për të përmirësuar mënyrën e jetesës, në mënyrë që qytetarët të gëzojnë shëndet dhe mirëqenie më të mirë.



Mbështetje për një jetë të shëndetshme

Tirana Bank nën moton: ‘Nuk mund të ndryshojmë fatin, por mund të bëjmë dikë të lumtur duke i ndryshuar ditën. Tirana Bank kujdeset!’ Punonjësit e bankës sollën buzëqeshje në fytyrat e fëmijëve që trajtoheshin në pavijonin onkologjik të Spitalit Pediatric në Tiranë. Stafi i bankës, me anë të një numri llogarie, mbledhi fonde të dhuruara personalisht për realizimin e kësaj feste dhe bleu dhurata me rastin e festave të fund vitit.


Dhurim vullnetar gjaku

Kjo nismë synon të motivojë individët që të dhurojnë gjak rregullisht në mënyrë vullnetare nëpërmjet bankave të mire organizuara për dhurimin e gjakut.

Mbështetur nga: Alpha Bank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Société Générale Albania, Raiffeisen Bank, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Tirana Bank, Union Bank.

OBJEKTIVI #4 Arsim Cilësor

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Bashkëpunim me institucionet financiare dhe qeveritë për të rritur dhe/ose investuar në financimin novator për projektet e arsimit.

Zgjerimi i aksesit dhe shfrytëzimi i kursimeve personale dhe produkteve të kredisë për t'u ardhur në ndihmë familjeve për të planifikuar dhe financuar shpenzimet e arsimit.

Ofrimi i këshillimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e marginalizuar për përmirësimin e rezultateve në mësim dhe aksesin e industrisë në rrjetin e talenteve të larmishme, çka ofron modele thelbësore për përmirësimin e përfshirjes sociale.

Rritja e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi të caktuara, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania financoi rindërtimin e shkollës për fëmijët me probleme me shikimin. Kjo shkollë, e cila akomodon fëmijë nga e gjithë Shqipëria, funksiononte pa kushtet e nevojshme për të ndihmuar në orientimin e fëmijëve. Mbështetja konsistoi në përshtatjen e ambienteve, në mënyrë që fëmijët me probleme me shikimin të mund të orientohen lehtësisht.

Banka Kombëtare Tregtare:

- ◆ Është partneri kryesor i FASTIP-it (Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën): Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD). Ajo organizoi ceremoninë e diplomimit për studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën. Ky vit akademik përkoj me 10 vjetorin e themelimit të FASTIP-it dhe të bashkëpunimit të Bankës Kombëtare Tregtare me Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Në këtë ceremoni, u diplomuan 26 studentë dhe 13 prej tyre u nderuan dhe mbetën shumë të kënaqur që përfituan kontratat e punës në të njëjtën kohë me diplomat e tyre, në mënyrë që të punësohen në vendet vakante të punës në BKT.

- ◆ Mbështet vazhdimisht institucionet publike, të cilët asistojnë grupet në nevojë. Banka Kombëtare Tregtare mbështeti Shkollën për Fëmijët me Nevoja të Veçanta në Vlorë, për të përmirësuar kushtet e mësimnxënies.
- ◆ Vazhdon të mbështesë përmirësimin e mjediseve shkollore në vendin tonë. Projekti i radhës ishte shkolla “Adem Bedolli” në Peqin, ku Banka Kombëtare Tregtare financoi riparimin e tabelave sinjalizuese të shkollës.



Banka Credins:

- ◆ Ofroi mbështetje financiare për shumë institucione në fushën e arsimit, duke përfshirë dhurimin e kompjuterëve, printerëve dhe pajisjeve të zyrës. Gjithashtu, nëpërmjet donacioneve, Banka Credins mbështeti organizimin e konferencave.
- ◆ Mbështeti organizimin e Konferencës Ndërkombëtare në Universitetin e Durrësit.
- ◆ Bashkëpunoi me Tirana Business University, ku të rinjtë përfshihen në një konkurs tre-mujor për t'u shndërruar në sipërmarrësit e së nesërme. Ky konkurs ka hyrë në vitin e tij të tretë.
- ◆ Ofroi mbështetje financiare për Drejtorinë Arsimore Kukës.



Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti nismën e Dhomës Italiane të Tregtisë në Shqipëri. Kjo nismë kishte për synim të ofronte bursa në Itali për studentët më të mirë të gjuhës italiane, në mënyrë që të ruajë nivele të kënaqshme të kërkesës për studentë shqiptarë që duan të vazhdojnë studimet në Itali.

FIBank Albania, në bashkëpunim me Ambasadën Bullgare në Shqipëri, me Bashkinë e Kukësit dhe DAR Kukës dhuruan 10 kompjuterë, përfshirë këtu edhe dhurata për Krishtlindje për fëmijët e shkollave në qytetin e Kukësit.

NBG Bank Albania i dhuroi Akademisë së Arteve në Tiranë kompjuterë dhe pajisje të tjera për të mbuluar nevojat e saj të përditshme.



Procredit Bank dhuroi artikuj dhe pajisje, si p.sh. kompjuterë për Laboratorët e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Politeknik.

Kredi për studentë

nga Alpha Bank Albania, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Société Générale Albania, Union Bank

Bankat mbështesin studentët që përballen me shumë sfida dhe, në morinë e këtyre sfidave, u ofron partneritet për të lehtësuar pagesat, duke u siguruar menaxhim më të mirë të kohës dhe duke u ofruar avantazhe konkurruese në lidhje me qasjen ndaj financave.



Nisma për dhurimin e librave

nga Alpha Bank Albania, Raiffeisen Bank

- ◆ **Alpha Bank Albania** mbështeti 22 biblioteka të shkollave në qytetin e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Korçës, Shkodrës, Lushnjës, Urës Vajgurore, Burrelit, Laçit, Tepelenës, Pogradecit, Himarës, Elbasanit, Përmetit, Kamzës dhe Gjirokastrës. U dhuruan 6,100 libra artistikë dhe shkencorë në 15 shkolla fillore dhe 7 gjimnaze. Të 22 bibliotekat e shkollave vuanin nga një mungesë e theksuar e titujve të kërkuar të librave për nxënësit dhe me këtë donacion, leximi kthehet në një nga veprimtaritë kryesore të nxënësve pas mësimit.



- ◆ **Raiffeisen Bank** dhuroi libra për bibliotekat e qyteteve të Lushnjës dhe Divjakës. Në bashkëpunim me bashkitë e Lushnjës dhe Divjakës, nën nismën “Qyteti i lexuesve”, banka bleu libra për bibliotekat publike të këtyre qyteteve.



Mentorimi vullnetar

nga Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania

- ◆ **Banka Credins** organizoi një vizitë në universitetet shqiptare publike dhe jo-publike, në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë për të kuptuar më mirë sfidat me të cilat përballen studentët dhe për të propozuar zgjidhje financiare për to.



- ◆ **Intesa Sanpaolo Bank Albania** iu bashkua nismës së Intesa Sanpaolo Group & Muzeut të Kursimeve (Museo del Risparmio), Gallerie d'Italia & Arkivit Historik për të festuar “Ditën Botërore të Kursimit!”. Intesa Sanpaolo Bank Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, mbështeti edukimin financiar që në moshë të re duke ofruar vullnetarisht, nëpërmjet punonjësve të saj, rolin e instruktorëve që do të prezantojnë dy programe mësimore (laboratorë multimedialë) të përgatitura nga Muzeu i Kursimeve në Torino, dedikuar grupeve të moshave të nxënësve të fillores dhe 9-vjeçares. Gjatë këtyre ditëve, rreth 10% e punonjësve dolën vullnetarë të jepnin mësim në shkollat fillore dhe 9-vjeçare në të gjithë vendin. Rreth 1,300 fëmijë nga mosha 6 deri në 10 vjeç dhe mbi 600 fëmijë nga mosha 11-14 vjeç u bënë pjesë e kësaj nisme, ku punonjësit e bankës folën për konceptet bazë të kursimit dhe rëndësinë që ajo ka në përmbushjen e dëshirave. Kjo nismë, duke qenë e para në llojin e saj, u mbështet nga një fushatë komunikimi e jashtme dhe e brendshme, nëpërmjet të gjitha kanaleve sociale të bankës, duke vazhduar të rrisë sensibilizimin



rreth “Artit të Kursimit” në çdo grup moshë dhe duke konfirmuar kontributin e bankës në fushën e Edukimit Financiar në Shqipëri.

Z. Silvio Pedrazzi, Drejtor Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania, si mbështetës i nismave për edukimin financiar dhe zhvillimin e të rinjve, ndau më 30 nëntor përvojën e tij me nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri”, duke folur për “Udhëzuesin e Sipërmarrësit” që erdhi pas “Mua-jit Kombëtar të Sipërmarrjes”, të organizuar nga Junior Achievement në Shqipëri. Më pas, drejtuesit e bankës mbajtën leksione të hapura në universitete të ndryshme.

Banka Credins dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania bashkëpunuan me “Junior Achievement” për programet e mentorimit në shkolla.

Raiffeisen Bank:

- ◆ Mbështeti rindërtimin e Shkollës së Baletit dhe siguroi kamerat e sigurisë për rritjen e mbikëqyrjes dhe sigurisë në shkolla.
- ◆ Raiffeisen Invest dhe Bashkia e Sarandës përruruan më 1 qershor kopshtin “3 Ketrushat”.
- ◆ Raiffeisen Invest në bashkëpunim me Bashkinë e Beratit rikonstruktuan mjediset e kopshtit “Murat Celebiu” në Berat. Ky projekt i dedikohet një grupi prej rreth 120 fëmijësh nga moshë 0 deri 6 dhe rikonstruksioni ishte i nevojshëm për shkak të kushteve shumë të këqija në ndërtesën ekzistuese.
- ◆ Mbështeti Departamentin e Financave të Fakultetit të Ekonomisë (Universiteti i Tiranës) në Konferencën e III-të Kombëtare për Financat. Në këtë aktivitet morën pjesë akademikë të njohur, studentë dhe profesionistë brenda vendit. Banka mbështeti aktivitetin “Dita e Hapur” si një mundësi që të diplomuarit të kalonin një ditë në mjediset e Universitetit të Filologjisë, përpara se të marrin vendimin për të ndjekur studimet në një universitet të caktuar.
- ◆ Akti për Qendrën Sociale përfundoi me sukses projektin “Demokracia në shtëpi”, me mbështetjen e Raiffeisen Invest.
- ◆ Organizoi më 7 mars festimet me disa nga Drejtoritë Rajonale Arsimore për të motivuar mësuesit dhe për të vlerësuar punën e tyre.
- ◆ Sponsorizoi ditën e diplomimit të organizuar nga Drejtoria Rajonale e Vlorës, për të mbështetur veprimtaritë për të diplomuarit.

Société Générale Albania në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës mbështeti konkursin “Innovate your way out”. Për Fakultetin e Ekonomisë,





ky është një aktivitet periodik që organizohet shpesh për të gjeneruar qasje krijuese dhe shpirt sipërmarrës. Sociéte Générale Albania luajti rolin e anëtarit të jurisë dhe dhuroi çmimin e dytë. Projekti i përzgjedhur për vendin e dytë quhet “Arsimi Virtual” dhe përfaqëson një ide të zbatueshme në shumë fusha. Grupi u ftua të bëhej pjesë e Inovacionit të Jashtëm dhe morri ftesë për të vizituar Laboratorin e Inovacionit të Sociéte Générale Albania për zhvillimin e ideve për veprimtarinë e vet trajnuese, procesin e shitjes, etj.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti:

- ◆ “Konkursin e Pikturës” të organizuar nga Rezidenca Studentore Universitare për të promovuar artistët dhe talentet e reja në fushën e artit dhe kulturës.
- ◆ Aktivitetet sportive të organizuara nga Drejtoria Arsimore Rajonale në Tiranë. Kjo ngjarje sportive u organizua falë një tradite shumë të suksesshme që është krijuar gjatë viteve të fundit në Rrethin e Tiranës me rastin e mbylljes së vitit shkollor.
- ◆ Organizimin e ceremonisë së diplomimit, një traditë e vjetër për qytetin e Vlorës dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë.



Credins Bank mbështeti gjimnazin “Bilal Golemi” në Urën e Kardhiqit, në Gjirokastrë, duke mbuluar shpenzimet për aktivitetin me biçikleta për 40 nxënës të shkollës, në kuadër të arsimit formal dhe programit mësimor të shkollës.

Mbështetje për publikimet

nga Banka Credins, Union Bank

Credins Bank ofroi mbështetje financiare për publikimin e librave nga autorë shqiptarë, si p.sh. “Loja që ndryshoi Shqipërinë” dhe “Bukuritë Shqiptare”.

Union Bank, mbështeti publikimin e monografisë së gjimnazit “Muharrem Çollaku” në Pogradec, me rastin e 60 vjetorit të themelimit të këtij gjimnazi.



Alpha Bank Albania, Banka Amerikane e Investimeve dhe **Tirana Bank** mbështetën aktivitetin “Rruga drejt suksesit”. Ky aktivitet që zgjati një ditë të plotë synonte të nxiste kapacitetet ndërpersonale të punonjësve, për sa i përket aftësive dhe përvojave. Mbi 50 punonjës të bankës morën pjesë në këtë event. Ai shërbeu gjithashtu si një aktivitet bamirës, pasi të gjitha të ardhurat shkuan për bamirësi.

Java e Parasë në Shqipëri

Mbështetur nga Alpha Bank Albania, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins, First Investment Bank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Procredit Bank, Société Générale Albania Bank, Tirana Bank, Union Bank.

Në kuadër të Javës së Parasë në Shqipëri, u organizuan aktivitete të ndryshme me synimin rritjen e nivelit të njohurive mbi financat. Banka e Shqipërisë (BSH), Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Junior Achievement dhe Shërbimi Kombëtar Rinor bashkëpunuan për të organizuar 17 aktivitete me pjesëmarrjen e 60 organizatave dhe 2,200 fëmijëve dhe të rinjve. Këto aktivitete përfshinin leksione, konkurse, vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë dhe në bankat tregtare, orë leksioni të hapura dhe konkurse për njohuritë mbi financat.

Lider për 1 ditë!

Mbështetur nga Alpha Bank Albania, Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Banka Ndërkombëtare Tregtare

Në bashkëpunim me Organizatën Junior Achievement Albania, bankat mbështetën aktivitetin "Lider për 1 Ditë". Një student i ekselencës nga gjimnazi u caktua që për gjatë gjithë ditës të shoqëronte një ekspert bankar për të fituar përvojë praktike dhe për t'u sjellë si lider përgjatë gjithë ditës së punës.

Për të nderuar të gjithë institucionet që kontribuan në këtë projekt u organizua një mbrëmje Gala.




OBJEKTIVI #5 Barazi Gjinore

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Përshtatja e proceseve të kredisë dhe metodave të huadhënies për të zgjeruar dhënien e kredive për NVM-të e drejtuara nga gratë, për shembull, duke ofruar kredi pa kolateral.

Rritja e përqindjes së grave në Bordet e shoqërive dhe rolet drejtuese, dhe investimi në politika dhe programe në mbështetje të grave në fuqinë punëtore, si dhe nxitja e organizatave në zinxhirin e vlerave për ndërmarrjen e nismave të ngjashme.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Me rastin e Festës së Gruas, më datë 8 mars u organizua në Tiranë konferenca “Të lulëzosh fuqishëm” nga MOPS, një organizatë që synon të mbështesë moralisht dhe materialisht nënat me fëmijë në moshë parashkollore. **Banka Amerikane e Investimeve** ishte sponsori i kësaj konference, në të cilën morën pjesë 220 nëna, të cilat vinin nga të gjitha zonat e vendit (urbane dhe rurale).

FIBank Albania në bashkëpunim me Fondacionin Spitalor të Nënës dhe Fëmijës ka filluar një nismë afatgjatë në formën e një fushate sensibilizimi të titulluar #celebrateHer për të rinjtë shqiptarë, për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave, sidomos gjatë muajve të shtatzënisë. Kjo fushatë do të vendosë në vëmendje zgjedhjet që mund të bëjnë njerëzit e zakonshëm për të pranuar ose refuzuar dhunën ndaj grave shtatzëna dhe gjithashtu do të ofrojë mbështetje për refuzimin e dhunës, duke prezantuar një platformë të përbashkët: “Mund ta ndalojmë dhunën ndaj grave”.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mori pjesë në një nga programet strategjike me rëndësi parësore për BERZH-in dhe u shndërrua në Institucion Financiar Partner (IFP) në Programin e Biznesit të Grave të Ballkanit Perëndimor, i cili u krijua për të mbështetur “gratë në biznes” në Ballkanin Perëndimor në sipërmarrje të vogla dhe të mesme. Programi përfshinte: Komponentin financiar; Komponentin e bashkëpunimit teknik; dhe Komponentin e mbështetjes së Grave në Biznes. Në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar me BERZH-in, u shpërndanë rreth 2 milionë euro kredi dhe reagimet dhe komentet e marra nga klientët ishin shumë të mira. BERZH-i organizoi një trajnim për gratë në biznes të titulluar “Lidershipi në praktikë”, ku ekspertët e ISBA-së prezantuan avantazhet e këtyre produkteve të dedikuara.

Për të festuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas, **Intesa Sanpaolo Bank Albania** u shpërndau të gjithë punonjësve një kartolinë të veçantë për të rritur sensibilizimin mbi rolin dhe fuqinë e grave në shoqëri! Kjo kartolinë përmbante moton e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për vitin 2017: “Gratë në botën e punës në ndryshim: një planet 50-50 deri në vitin 2030”. Gjatë muajit mars, ISBA ofroi paketa të dedikuara dhe kredi me norma interesi më të mira për gratë.


OBJEKTIVI #7 Energji e përbalueshme dhe e pastër

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Aplikimi i ekspertizës financiare ndaj modeleve të çmimit të energjisë, të cilat përmbushin tre objektivat e qëndrueshmërisë financiare, efijencës së energjisë dhe aksesit universal, duke përfshirë veçanërisht shqyrtimin e nevojave për energji të komuniteteve me të ardhura të ulëta.

Nënvizimi i zhvillimeve të energjisë së rinovueshme, si për shembull plantacionet e mullinjve të erës dhe burimet e energjisë diellore për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie gjithëpërfshirëse me nivel të ulët karboni.

Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt dhe me shërbime moderne të energjisë, rritja në mënyrë të ndjeshme e pjesës së energjisë së rinovueshme në kombinimin e energjisë së botës, dhe dyfishimi i normës globale për përmirësimin e efijencës së energjisë.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Procredit Bank Albania, si pjesë e grupit ProCredit, ofroi mbështetje për mbrojtjen e mjedisit dhe ndihmoi në ngadalësimin e avancimit të ndryshimeve klimatike, dhe si pjesë e përgjegjësisë së saj sociale të korporatave, ajo i konsideron këto përpjekje si elemente kritike të zhvillimit ekonomik të përgjegjshëm në aspektin social.

Banka kërkon të reduktojë vazhdimisht ndikimet negative në mjedis që ajo shkakton, dhe po ashtu edhe ndikimet negative të klientëve të saj, dhe të kontribuojë në ndërgjegjësimin e stafit, të klientëve dhe të publikut rreth çështjeve mjedisore, duke zbatuar masa të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

ProCredit Bank vazhdoi të mbështesë investimet “E gjelbra” nëpërmjet Kredive të Gjelbra, si për klientët individë ashtu edhe për ata të biznesit. Portofoli i Kredive të Gjelbra të bankës arrin një shumë prej 19,8 milionë euro dhe përbën 11% të totalit të portofolit të kredive. Për vitin 2017, banka ka financuar projekte ekologjike me një shumë prej rreth 9.1 milionë eurosh, të cilat u janë shpërndarë bizneseve, agrobizneseve dhe klientëve individë. Banka do të vazhdojë të ketë në fokus rritjen e ndërgjegjësimit rreth masave për efijencën ndaj energjisë, duke bërë përpjekje të mëdha për t’u shpjeguar klientëve përfitimet që vijnë nga investimi në teknologjitë miqësore ndaj mjedisit.

Union Bank nxit klientët e saj dhe publikun të mbrojnë natyrën dhe të bëjnë ndryshime novatore për të përdorur energjinë e rinovueshme. Banka ofron një produkt të veçantë kredie për blerjen e paneleve diellore me normë të ulët.

OBJEKTIVI #8 Punë dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Puna me aktorët kyç për gjetjen e zgjidhjeve praktike, të cilat do të ndryshojnë prirjen e bankave ndërkombëtare për tërheqjen e shërbimeve bankare përkatëse për shkak të kuadrit ligjor dhe rregullator.

Zgjerimi i mikrofinancave (kursime, kredi dhe sigurime) për pronarët e bizneseve të vogla.

Zgjerimi i financave për “të mesmen që mungon”, d.m.th. ndërmarrjet e vogla që lindin nga mikrofinanca, të cilat ende nuk janë në gjendje të marrin kredi nga sistemi bankar formal.

Sigurimi i praktikave të synuara për të rinjtë me preardhje nga shtresat e pafavorizuara, me qëllim promovimin e lëvizshmërisë sociale, duke rritur gjithashtu performancën e shoqërisë përmes rritjes së diversitetit të fuqisë punëtore.


Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve financiare vendase për nxitjen dhe zgjerimin e aksesit në shërbimet bankare, të sigurimeve dhe financiare për të gjithë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Panairët e Punës dhe Studimit

nga Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Procredit Bank, Union Bank

Bankat në Shqipëri kanë mbështetur dhe zhvilluar për shumë vite radhazi programe të cilat përqendrohen në uljen e nivelit të papunësisë në vend dhe vazhdimisht ofrojnë mundësi punësimi për pozicione të ndryshme në sektorin bankar, si edhe praktika për studentët. Në kontekstin e mbështetjes dhe nxitjes së punësimit, këto banka morën pjesë në lloje të ndryshme panairësh (panairi i punës, panairi i studimit, panairi i karrierës) të organizuara nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në partneritet me Bashkinë e Tiranës dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Universitetin e Tiranës, Universitetin e Nju Jorkut në Tiranë, Universitetin Evropian të Tiranës, Universitetin Epoka dhe Universitetin Metropolitan.



Banka Amerikane e Investimeve mbështeti aktivitetin “EU Transit – Tirana Farm”, të organizuar më datat 19-20 maj nga Bashkia e Tiranës, i cili synonte të mbështeste dhe zhvillonte nismat e reja dhe nxitjen e prodhimit vendas.


Banka Credins bashkëpunoi me AK Invest dhe Postën Shqiptare, për të ngritur një infrastrukturë më të favorshme për më shumë qasje dhe lehtësira të shërbimeve bankare për të gjithë qytetarët dhe klientët, edhe në fushat ku banka nuk është e pranishme. Kostot e përdorimit të shërbimeve nga ana e klientëve për këto skema mbulohen nga Banka. Për sa i përket zgjerimit të qasjes ndaj shërbimeve bankare dhe qenies më afër me klientët, Banka Credins ka rikonstruktuar dhe rijetësuar disa nga degët ekzistuese. Për më tepër, numri i degëve dhe bankomateve të reja në të gjithë vendin është rritur, duke arritur aktualisht në 58 degë dhe 68 bankomate. Gjatë vitit 2017, numri i transaksioneve në bankomate ka arritur në 1,590,054.

Banka Credins ka bashkëpunuar me programet qeveritare dhe bashkiake për të promovuar punësimin e të rinjve dhe mundësitë e barabarta për të gjithë, duke ofruar mundësi punësimi për 17 persona, 10 prej të cilëve janë tashmë të punësuar në Bankën Credins.

Mbështetje për forumet ekonomike

nga Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins, Union Bank

- ◆ **Banka Amerikane e Investimeve** mbështeti Forumin e Financës së studentëve të UET-së: “Ndërmjetësit financiarë në Shqipëri: Problematikat dhe sfidat”.
- ◆ **Banka Kombëtare Tregtare** mbështeti organizimin e Konferencës Ndërkombëtare, të titulluar “Perspektivat socio-ekonomike në epokën e globalizimit të shekullit XXI”. Objektivi i kësaj konference ishte zhvillimi i mëtejshëm i aftësive profesionale të pedagogëve të FE-UT. Gjithashtu, Banka Kombëtare Tregtare ka financuar Universitetin “Aleksandër Moisiu”, duke i ofruar mbështetje për Konferencën e 13-të Ndërkombëtare të AESECU-t me temë “Sfidat Sociale dhe Ekonomike në Evropë gjatë viteve 2016-2020”.
- ◆ **Banka Credins** mbështeti konkursin “Sipërmarrësit e së nesërme” të organizuar nga Tirana Business University.
- ◆ **Union Bank** mbështeti konkursin e startup-it “Hapat për të ngritur një biznes të suksesshëm” të organizuar nga Tirana Business University, i cili synonte të nxisë dhe mbështesë studentët që zhvillojnë ide biznesi.





Kontributi nga **Intesa Sanpaolo Bank Albania:**

- ◆ Banka beson se sukcesi i arritur lidhet me njohuritë profesionale të punonjësve dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për klientët. Një program i mirë-ndërtuar trajnimi, i cili u zhvillua në vitin 2017, u mësoi punonjësve të bankës se çfarë pritej prej tyre dhe, ajo çfarë është më e rëndësishme, mënyrën si t'i realizojnë këto pritshmëri. Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, u organizuan shumë trajnime brenda dhe jashtë institucionit, dhe/ose në bashkëpunim me strukturat trajnuese të ISBA-së.
- ◆ Gjatë vitit 2016, ISP prezantoi Programin e Menaxhimit të Talenteve, sukcesi i të cilit vijoi me hapat e mëtejshëm të ndërmarrë në vitin 2017 në ISBA, që nga faza përzgjedhëse dhe deri te pjesëmarrja e stafit të bankës në këtë program. Këtyre pjesëmarrësve iu dha një mundësi për të ndjekur një rrugë zhvillimi të personalizuar ndërkombëtare dhe profesionale me kohëzgjatje nga 3 deri në 5 vjet. Ecuria dhe zhvillimi i punonjësve matet nëpërmjet sistemit të vlerësimit vjetor GPS, detyra kryesore e të cilit nuk është vetëm vlerësimi i objektivave të punonjësve përballë rezultateve që ata arrijnë, por edhe planifikimi i detyrave dhe objektivave kyçe të punonjësve, të cilat mbështesin strategjitë e bankës për periudhat në vijim.
- ◆ Një nga mesazhet e Drejtorit Ekzekutiv, z. Pedrazzi drejtuar stafit gjatë vitit 2017 ishte mesazhi nga Këshilli Drejtues i Grupit Intesa Sanpaolo që zhvilloi Programin Ndërkombëtar të Kujdesit Shëndetësor me qëllim ofrimin e ndihmës më të mirë të mundshme për punonjësit që vuajnë nga sëmundje të rënda. Programi garanton që kolegët me sëmundje të rënda të mos lihen pas dore dhe të përfitojnë kujdesin më të mirë të mundshëm. Të gjithë punonjësit që kanë një marrëdhënie pune pa afat janë të regjistruar automatikisht në këtë program.
- ◆ “Seanca bisedimesh të hapura” është një nismë e vazhdueshme e Drejtorit Ekzekutiv të bankës ku të gjithë punonjësit janë të ftuar të marrin pjesë lirish, duke u ofruar një mundësi për të dëgjuar dhe diskutuar rreth temave të ndryshme profesionale dhe ecurisë në të ardhmen. Seanca e muajit maj 2017 u përqendrua në diskutimet rreth objektivave të bankës, arritjet dhe strategjitë për të ardhmen.
- ◆ Intesa Sanpaolo Bank Albania nënshkroi memorandumin e bashkëpunimit me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për Programin e Praktikave të Punës.
- ◆ Banka mori pjesë në diskutimin “Forcimi i partneritetit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara” të organizuar nga Zëvendës Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në mjediset e Qendrës Rinore të Tiranës më 23

shkurt, ku disa biznese të suksesshme ndanë përvojat e tyre në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në përmbushje të detyrimeve të tyre ligjore dhe zbatimin e Politikave për Përgjegjësinë e Korporatave në korporatat e tyre përkatëse. Gjatë vitit 2017, një tjetër person me aftësi të kufizuara u punësua nga Intesa Sanpaolo Bank Albania.

- ◆ 28 prilli, Dita Botërore e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë! Për të festuar këtë ditë, Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Intesa Sanpaolo Bank Albania u shpërndau një mesazh sensibilizimi të gjithë punonjësve rreth zhvillimit të kulturës së korporatave dhe ndërgjegjësimin për më shumë siguri dhe shëndet për të gjithë stafin e bankës dhe për klientët e saj. Ky mesazh shoqërohej me një kartolinë të veçantë, e cila përmbante informacione rreth kësaj dite dhe temës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për vitin 2017: Optimizimi i mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave të OSH-së.
- ◆ Edicioni i 8-të i Ditës Ndërkombëtare të Sipërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme u organizua nga Confindustria Italiane në bashkëpunim me shoqatat dhe bizneset, duke u përqendruar në luftën kundër mallrave falso. Për të dytin vit radhazi, Confindustria Albania u përfshi në këtë nismë, dhe në bashkëpunim me Intesa Sanpaolo Bank Albania, organizuan një vizitë të studentëve të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në ambientet e Qendrës së Trajnimit të Bankës. Studentët patën mundësinë të familjarizoheshin me punën e përditshme të bankës dhe fokusin e saj në fushën e Edukimit Financiar dhe me të ardhmen e Bankingut nëpërmjet një prezantimi interesant të përgatitur nga Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Organizimit.

Procredit Bank:

- ◆ Vazhdoi të ofronte programe punësimi, ProCredit Entry Programme, një program gjithëpërfshirës trajnimi për zhvillim për të sapo-diplomuarit dhe individët me përvojë në fusha të ndryshme.
- ◆ Takime me studentë – për të dhënë informacione të plota dhe mundësi të barabarta për të gjithë individët që synojnë të jenë pjesë e ProCredit Bank. Banka ka organizuar takime me persona të interesuar, të cilët janë diplomuar në fakultetet shqiptare: si Universiteti Luigj Gurakuqi në Shkodër, Fan Noli në Korçë, si edhe në Tiranë.
- ◆ Fondi Evropian i Investimeve (FEI) dhe grupi ProCredit po ofrojnë një fond shtesë prej 450 milionë eurosh për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme novatore (SME-të), duke vendosur në dispozicion të këtyre sipërmarrjeve një total prej 820 milionë eurosh në njëmbëdhjetë shtete.





Këto marrëveshje u nënshkruan nën nismën InnovFin të Komisionit Evropian, të mbështetur nga programi Horizon 2020 për kërkim shkencor dhe inovacion. Nisma InnovFin u mundëson bankave pjesëmarrëse t'u ofrojnë kredi shoqërive novatore me anë të një garancie të dhënë nga FEI.

Raiffeisen Bank mbështeti qendrën “Act for Society” në organizimin e aktivitetit “Power Up Community”. Banka shpërndau çmime për 3 projektet më të mira të përgatitura nga studentë, të cilët do t'i vinin ato në zbatim në qytetet e tyre në mënyrë që të përmirësonin standardet e jetesës dhe të rrisnin ndërgjegjësimin për kujdesin ndaj mjedisit në qytetet ku jetojnë.

Veneto Banka vlerësoi punën e bërë në konkursin mes shkollave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe rrugëtimin e tyre të qëndrueshëm, të organizuar nga Bashkia e Tiranës dhe Eco Tirana. Veneto Banka, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Pierluigi Caferri, i dha çmimin e parë shkollës “Misto Mame” me projektin “Tirana në sytë e mi”.



OBJEKTIVI #9 Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Rritja e financimit afatgjatë për partneritetet publike-private në sektorin e transportit, energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës së komunikimit për të kontribuar në zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve me aftësi ripërtëritëse.

Sigurimi i investimeve në infrastrukturë në sferën e influencës përbën ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta, grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara (përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).

Rritja e aksesit të ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, duke përfshirë kreditë e përbalueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirin e vlerave dhe në tregje.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive rezervë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptim më të gjerë të teknologjive të pastra dhe të shëndosha në aspektin mjedisor dhe proceseve industriale, në pajtim me të gjitha vendet që veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse.


DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Sigurimi i efikasitetit në investimet në infrastrukturë nga Alpha Bank Albania, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins

Alpha Bank Albania ofroi kredi për të financuar ndërtimin e autostradës Durrës - Kukës - Morinë ose siç njihet ndryshe "Rruga e Kombit".

Banka Kombëtare Tregtare ofroi mbështetje financiare për:

- ◆ Agjencinë për Zhvillimin Rajonal për blerjen e mobilieve të reja për zyrën.
- ◆ Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë për të përmirësuar kushtet e tyre të punës.
- ◆ Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, duke i dhuruar pajisje elektronike.





- ◆ Drejtorinë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor në Lushnje, duke i dhuruar pajisje kompjuterike.
- ◆ Bashkinë e Malësisë së Madhe, duke i dhuruar pajisje për zyrën, si tavolina, karrige dhe rafte, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës në institucionet që ofrojnë shërbime publike.
- ◆ Komisionarin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të përmirësuar infrastrukturën e zyrës së Komisionarit.
- ◆ Investime në “Rrugën e Kombit” me produktet e saj të kredisë.
- ◆ Investimin e stadiumit të ri “Qemal Stafa” nëpërmjet produkteve të saj të kredisë.

Banka Credins ka mbështetur projektin e financimit të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Sarandë, Repartit Usharak Nr. 4001, Agjencisë së Trajtimin të Pronave. Për më tepër, ka ndihmuar me pajisje fizike, si aparatura, pajisje për ngrohje dhe për zyrën në institucione të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, dhe Qendra Shëndetësore nr.2 në Berat.

Java e Inovacionit

nga Banka Amerikane e Investimeve dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania

Bankat ofruan mbështetje për Javën e Inovacionit, më 13-22 maj 2017, të organizuar në bashkëpunim me Ministrinë për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Fibank Albania prezantoi një sërë fushatash të suksesshme në rrjetet sociale si “#LoveSummerTravel” ose “Digital Photography”. Secila prej këtyre fushatave pati në fokus kryesor nxitjen e shoqërisë për të përdorur shërbimin e internetit në celular dhe ç’është më e rëndësishme, që të mund t’i shohim rrjetet sociale si një instrument të ri që ofron mundësi të mëtejshme investimi. Meqë këto fushata rezultuan shumë të suksesshme, Fibank do të vazhdojë më tej me zbatimin e tyre në strategjinë vjetore të bankës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Novathon #withPBZ, Maratona e Inovacionit e Grupit Intesa Sanpaolo u organizua në bashkëpunim me Bankën Privredna Zagreb, në Zagreb më 23-24 shtator. Në konkursin e programimit për 24 orë morën pjesë 144 pjesëmarrës nga 7 vende konkurruese të organizuar në 24 grupe, 22 folës ndërkombëtarë, 21 partnerë dhe më shumë se 300 të ftuar. Banka synonte të ishte në pararojën e konkursit të inova-



cionit për ofrimin e shërbimeve bankare nëpërmjet platformave të lehta në përdorim për *internet banking* dhe *mobile banking* (Intesa Mobile).

Për këtë qëllim, Banka vazhdon të vërë në zbatim sisteme dhe instrumente për të thjeshtuar produktet dhe ruan komunikimin e qartë me klientët në lidhje me produktet dhe shërbimet e bankës nëpërmjet të gjitha kanaleve të saj të disponueshme si p.sh. bankomate, internet banking, mobile banking, SMS-ve dhe email-ve. Në këtë pikëpamje, veprimtaritë e kryera gjatë vitit lidhen me tre shtyllat kryesore:

- ◆ Prezantimi i shërbimeve të reja sipas dëshirave të klientëve.
- ◆ Mbledhja e reagimeve dhe komenteve të klientëve nëpërmjet kanaleve të ndryshme, duke na dhënë kështu një panoramë të plotë, nëpërmjet së cilës ne kemi mundur të identifikojnë mangësitë dhe të rregullojmë problemet.
- ◆ Përmirësimi i sistemit të trajtimit të ankesave.

Procredit Bank prezantoi një koncept të ri bankar, Bankingu i Drejtpërdrejtë. Shërbimet elektronike janë një instrument shumë i rëndësishëm për menaxhimin e transaksioneve të klientëve tanë, ndaj dhe investimi në shërbime të përparuara online do të mbetet një nga komponentët kyç në modelin tonë të biznesit dhe një prej përparësive thelbësore. Shërbimet bankare dhe financiare që ne ofrojmë sipas këtij koncepti ofrojnë zgjidhje shumë elastike që i dedikohen Klientëve Privatë, duke bërë që ata të përfitojnë nga avantazhe të tilla si kursimi i kohës dhe i parave.

Raiffeisen Bank mbështeti:

- ◆ Edicionin e çmimeve ICT, një festival për idetë kreative dhe inovacionin për të pestin vit radhazi.
- ◆ Oscar, një konferencë dy-ditore me të ftuar të rinj që ndanë mes tyre njohuritë dhe frymëzimin në fushën e teknologjisë së informacionit.
- ◆ Forumi i Sigurisë nga Infocom – Dilemat kibernetike në mijëvjeçarin e ri – një konferencë rreth teknologjisë së informacionit.

Union Bank i është bashkuar Programit për Lehtësimin e Tregut të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BER-ZH) duke nënshkruar një marrëveshje sipas së cilës Union Bank do të jetë një bankë që do të lëshojë garancitë për financimin e tregtisë në mbështetje të aktivitetit të importit dhe eksportit të shoqërive vendase. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet gjithashtu importit të teknologjive dhe shërbimeve të përparuara që mbështesin tranzicionin e vendit drejt një ekonomie të gjelbër.



OBJEKTIVI #10 Zvogëlim i Pabarazive

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Përdorimi i teknologjive të reja të tilla si shërbimet e pagesave të parave të lëvizshme për të krijuar modele operative dhe shpërndarëse më efikase dhe efektive për tregjet e reja, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare.

Zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja të tilla si të dhënat me kapacitet të madh dhe informatika “cloud” për të fituar njohuri të reja që përmirësojnë analizat e riskut dhe të mundësive.

Sigurimi i mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive të rezultateve, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjisllacionit, politikave dhe masave të duhura në këtë drejtim.

Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve. Lehtësimi i migrimit të drejtë, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti për të dytin vit radhazi mbrëmjen gala “Promovo ndryshimin, mbështet përparimin”. Ky është një aktivitet për mbledhjen e fondeve që ka si synim strehimin, ushqyerjen, mbështetjen psikologjike, trajnimin e vazhdueshëm, arsimimin dhe punësimin e të rinjve LGBT, të cilët janë viktimat e dhunës dhe diskriminimit dhe që banojnë në qendrën “Streha”.

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti financiarisht Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës për organizimin e maratonës me temë “Kundër Diskriminimit dhe Racizmit”, ku morën pjesë studentë dhe pedagogë nga Universiteti i Vlorës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania iu bashkua fushatës së sensibilizimit të UNHCR (Agjencia e Kombeve të Bashkuara





2017 *Zvogëlimi i pabarazisë brendapërbrenda vendeve dhe mes tyre!*

për Refugjatët) në Ditën Botërore të Refugjatëve. Shifrat më të fundit të Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, UNHCR, tregojnë se të paktën 65.6 milionë njerëz – 1 në çdo 113 anëtarë të familjes njerëzore – kanë qenë të detyruar të zhvendosen nga shtetet përkatëse ose përtej kufijve. Motoja e fushatës së sensibilizimit është “Tani më shumë se kurrë i gjendemi pranë Refugjatëve! # WITHREFUGEES”.

Tirana Bank dhuroi një pemë Krishtlindjesh; një nismë e dedikuar atyre që nuk mund të kalojnë pushimet në familje dhe stafi përgatiti dhurata personalisht dhe me shumë dashuri.

Mbështetja e fëmijëve me sindromën Down

nga Alpha Bank Albania, NBG Bank Albania, Raiffeisen Bank, Tirana Bank, Union Bank

Alpha Bank Albania mbështeti rinovimin e dhomës së re për terapi të fëmijëve të Fondacionit Down Syndrome Albania, i cili është i vetmi fondacion që ofron mbështetje falas për familjet që kanë fëmijë me sindromën Down.

Për të tretin vit radhazi, **NBG Bank Albania** mbështeti veprimtaritë e Down Syndrome Albania, duke qenë një prej sponsorëve të saj.

Raiffeisen Bank mbështeti aktivitetet për mbledhjen e fondeve gjatë Ditës Botërore të Sindromës Down dhe aktivitetit Buddy Walk, i cili u mbajt në muajin tetor me rastin e Muajit të Ndërgjegjësimit për Sindromën Down.


Tirana Bank mbështeti Qendrën e Performancës dhe Zhvillimit të Fondacionit Down Syndrome Albania, si edhe organizimin e përvjetorit të 3-të të “Qendrës së Arritjeve dhe Zhvillimit të Fondacionit Down Syndrome Albania”.

Union Bank mbështeti për të dytin vit radhazi Fondacionin Down Syndrome Albania, si dhe u bë pjesë e fushatës që mundësoi sigurimin e shërbimeve terapeutike për fëmijët me sindromën Down. Gjithashtu, Union Bank, për aktivitetin e fund vitit, zgjodhi të përgëzonte klientët dhe bashkëpunëtorët me nga një kartolinë të përgatitur nga këta fëmijë.

Kontribute në Fshatin e Fëmijëve SOS, një bashkëpunim jetëgjatë

nga Banka Credins, Banka Ndërkombëtare Tregtare dhe Tirana Bank

Bankat vijnë me angazhimin e tyre për të “adoptuar” disa nga fëmijët e fshatit SOS. Sponsorizimi i jetës së këtyre fëmijëve është një mbështetje jetëgjatë dhe e vazhdueshme për kujdes të personalizuar dhe promovim për zhvillim, arsimim, kujdes shëndetësor, veprimtari sociale, sportive dhe argëtuese për këta fëmijë.



OBJEKTIVI #11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Vendosja e bashkëpunimit me palët e interesit në qytet për të analizuar dhe rritur rezistencën e sistemeve të ndërvarura, si për shembull infrastruktura e transportit dhe shërbimet komunale, të cilat përbëjnë themelet e rezistencës së aseteve individuale.

Edukimi i pronarëve të shtëpive dhe bizneseve për materialet dhe teknikat e ndërtimit rezistente ndaj motit, dhe ofroi stimuj për zbatimin e tyre.

Shpërndarja e informacionit për rrezikun, me qëllim informimin lidhur me legjislacionin e qeverisë mbi zonimin e tokës dhe kodet e ndërtimit në praktikë.

Përforcimi i përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.

Sigurimi i aksesit universal në hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania mbështeti ndërtimin e kullës së vrojtit të plazhit në qytetin e Velipojës, i cili është një nga qytetet bregdetare me numrin më të lartë të aksidenteve gjatë stinës së verës. Kulla e re nuk do të shërbejë vetëm gjatë verës, por do të përdoret gjithashtu për trajnime kombëtare për rojet e reja të plazhit.

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti:

- ◆ Organizimin e “Festivalit të interpretuesve të këngës popullore për fëmijë” në mbështetje të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore të fëmijët shqiptarë, e organizuar nga Shoqata e Qytetit të Albanëve, duke vijuar kështu bashkëpunimin disa vjeçar.
- ◆ Universitetin Polis për të organizuar konferencën “Strehim i përballueshëm për të gjithë” dhe tregoi mbështetjen e saj për temën e problematikave të strehimit, në mënyrë që të ketë një ndikim pozitiv të institucionet që ofrojnë këto lloj shërbimesh.



2017 *Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, elastik dhe të qëndrueshëm!*

Banka **Société Générale Albania** kontribuoi në krijimin e një rruge të sigurt te Syri i Ciklopit, duke vendosur tabela drejtuese përgjatë rrugës.


PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- ◆ Dy veprimtari të organizuara gjatë Ditës së Verës: inaugurimin e Pazarit të Ri dhe festën tradicionale të organizuar në Elbasan.
- ◆ Më 10 qershor, banka mbështeti organizimin e “Festivalit Ndërkombëtar të Karnavaleve” në Korçë.
- ◆ Maratonën e Këngës, që është produksioni më i suksesshëm i televizionit Klan, e cila u organizua gjatë sezonit veror në qytet kryesore të vendit. Ky spektakël përkoi me 12-vjetorin e hyrjes së UNESCO-s në qytet, falë mbështetjes së Bankës Amerikane të Investimeve.
- ◆ Edicionin e tetë të Simpoziumit “Skulptura në Park 2017”, i cili u mbajt në Korçë më 15-22 korrik.
- ◆ Festivalin e Birrës në Korçë, me pjesëmarrjen e mbi 100,000 vizitorëve.
- ◆ Zbukurimin me drita të qendrës Livadhja.
- ◆ Ditën Amerikane, e cila solli në vëmendje marrëdhëniet e hershme të këtij qyteti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një ekspozitë me fotografi dhe letra të ruajtura nga familjet korçare; ushqime, muzikë dhe lojëra për fëmijë tradicionale amerikane në Pazarin e Vjetër të Korçës, e pasuruan fundjavën për banorët dhe vizitorët në Korçë.

Banka Credins mbështeti:

- ◆ Ekspozitën e kryeveprave të artit Italian të viteve 1900 të titulluar “Novecento”, në Galerinë Kombëtare të Arteve, duke mundësuar ardhjen e koleksionit nga Galeria e Arteve Moderne në Romë. Për më tepër, banka bashkëpunoi me Shoqatën Kulturore VIZart për të publikuar katalogë për aktivitetin kulturor “Bienalja e Dytë Ndërkombëtare e Akvarelit Tiranë 2017”.
- ◆ Qendrën Kulturore të Fëmijëve, Teatrin e Kukullave për prodhimin e klipit “Shqipëria Ime”, Shoqatën “Eja në teatër” për të vënë në skenë shfaqjen “Shirli Valentina” dhe Aktivitetin e Bienales 2017, të organizuar nga Ministria e Kulturës.
- ◆ Federatën Shqiptare të Aeronautikës për veprimtarinë sportive “Paragliding 2017” dhe Federatën Shqiptare të Bilardos për organizimin e Kampionatit Evropian të Bilardos 2017.
- ◆ Spitalin Rajonal Shkodër, me kostot e pajisjeve të ajrit të





kondicionuar, si edhe Qendrën Shëndetësore Nr.1 në Tiranë, duke mbuluar kostot e vendosjes së stacioneve të biçikletave afër Poliklinikës Iraniane.

- ◆ Krijimin dhe instalimin e një skulpture moderne të artit publik nga Butrint Morina në qendër të qytetit të Lezhës. Kjo vepër arti ishte pjesë e konkursit kombëtar për artin në hapësirat publike të organizuar dhe të financuar nga Banka Credins.

Intesa Sanpaolo Bank Albania ishte një nga mbështetëset e TEDx Tirana, një aktivitet lokal që solli në Shqipëri formatin e mirënjohur ndërkombëtar TED Talks nga Qendra IDEO dhe një grup vullnetarësh energjikë që i dhanë vëmendje të hollësishme çdo aspekti të saj.

NBG Bank Albania mbështeti programin e organizuar nga grupi mjedisor i Shkollës Omiros për të ndërgjegjësuar publikun mbi përdorimin e çantave prej cohe në vend të qeseve plastike në zonën e Pazarit në Korçë.

Raiffeisen Bank mbështeti:

- ◆ Festivalin "South Outdoor", në Pilur. Qëllimi kryesor i festivalit ishte prezantimi i një zone turistike kaq të pasur si Piluri për turistët shqiptarë dhe të huaj.
- ◆ Festivalin e Resë, për të promovuar një-vjetorin e instalimit të "Resë" në Tiranë me artistë nga mbarë bota, me synimin promovimin e jetës kulturore në Tiranë duke e pasuruar me aktivitete ditore.





OBJEKTIVI #12 Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Zhvillimi i modeleve të reja për vendosjen e çmimeve për nxitjen e një jetë më të qëndrueshme.

Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzimit efikas të burimeve natyrore.

Ulja në mënyrë thelbësore e prodhimit e mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.

Nxitja e shoqërive, veçanërisht shoqëritë e mëdha dhe ndërkombëtare, për adaptimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.

Sigurimi që njerëzit të kenë në çdo vend informacionin dhe sensibilizimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB) në sajë të bashkëpunimit me riciklimin e gjelbër, në tre-mujorin e parë të vitit 2018 mori raportin vjetor të vitit 2017, që tregonte ndikimet pozitive në mjedis, si më poshtë: Duke ricikluar 616 kg mbetje letre dhe kartoni, ICB-ja shmangu emetimin e CO2 me rreth 0,8 ton. Kjo është e barabartë me:

- ◆ 11.4 pemë të shpëtuara
- ◆ 22.5 metër kub ujë
- ◆ 2525.6 kilovat energji e kursyer
- ◆ 5.5 fuçi nafte
- ◆ 16.8 ton ndotës ajri të shmangur
- ◆ 2.0 metër kub hapësirë e kursyer në landfille

Konkursi “JU MUND!” i ECO Tirana! **Intesa Sanpaolo Bank Albania** mbështeti konkursin ndërmjet shkollave me temë “Mbledhja e diferencuar e mbetjeve dhe rrugët e qëndrueshme të saj”, një konkurs i promovuar nga Bashkia e Tiranës dhe Eco Tirana me nxënës nga gjimnaze të ndryshme të kryeqytetit. Banka e shpërbleu këtë projekt, që u radhit i pari për origjinalitetin dhe funksionalitetin.

ProCredit Bank zbatoi konceptin e Sistemit të Administrimit Mjedisor në Shqipëri. Falë masave të brendshme, gjatë vitit 2017, ProCredit Bank Albania uli konsumin në terma absolute, krahasuar me vitin e shkuar

- ◆ Konsumi i energjisë me 21% (rreth 393,786 kWh/vit)
- ◆ Konsumi i letrës me 17% (rreth 1129.84 kg/vit)
- ◆ Konsumi i ujit me 21% (rreth 655 m3/vit)
- ◆ Konsumi i karburantit për transport me 20% (rreth -7,349 litra/vit)

OBJEKTIVI #13 Veprim për Klimën

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Investime në – dhe/ose rritje të financimit për – zbutjen e rrezikut klimatik, qëndrueshmërinë klimatike dhe adaptimin klimatik duke përfshirë hua shtesë dhe instrumente të kapitalit.

Marrja e masave për matjen, zvogëlimin dhe raportimin e ekspozimit klimatik dhe progresit të veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike, me vijimin e rritjes së nivelit të transparencës dhe përputhshmërisë së raportimit në të gjithë sektorin e industrisë.

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Integrimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe planifikime kombëtare. Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, adaptimi, zvogëlimi i ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.


DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti financiarisht:

- ◆ Green Line Albania me prodhimin e veshjeve për programin e tyre vullnetar për të pastruar bregdetin shqiptar nga lloje të ndryshme mbetjesh që mund të kenë ndotur mjedisin.
- ◆ Hidrocentralet, nëpërmjet produkteve të kredisë të ofruara. Hidrocentralet e reja, të cilat janë investime të investitorëve privatë, shqiptarë ose të huaj, për prodhimin e energjisë së rinovueshme me një periudhë koncesionare të përbashkët prej 35 vitesh (në varësi të kontratës koncesionare).

Banka Credins:

- ◆ Mbështeti projektin “Pylli Orbital”, një nismë të Bashkisë së Tiranës. Banka ndihmoi në mbjelljen e 110 pemëve në zonën e Liqenit të Thatë, duke ndërgjegjësuar komunitetin për mjedisin dhe duke promovuar dhe zgjeruar hapësirat e gjelbra të Tiranës. Drejtori Ekzekutiv i Bankës, z. Maltin Korkuti mori pjesë në mbjelljen e këtyre pemëve



bashkë me anëtarë të tjerë të stafit. Banka mbështeti gjithashtu Bashkinë e Shkodrës me financimin për zbulimin e qytetit për festimet e fund vitit.

- ◆ Më 5 korrik, me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, Banka Credins vuri në jetë një fushatë komunikimi në të gjithë bankomatet dhe televizorët e instaluar në degët e saj, për të rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen e kafshëve të egra.

Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- ◆ Një kontribut për sheshin e Pazarit të Ri në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës! Intesa Sanpaolo Bank Albania kontribuoi në një nga zonat më të rëndësishme të kryeqytetit, duke dhuruar 7 pemë ulliri 100-vjeçare për sheshin Avni Rustemi te Pazari i Ri.
- ◆ Ora e Tokës, një veprim solidariteti për ndryshimet klimatike! Më 25 mars 2017, për 60 minuta, të gjitha dritat e mjediseve të Intesa Sanpaolo Bank u fikën, në mbështetje të Fushatës Botërore “ORA E TOKËS”. Një simbol i angazhimit tonë për planetin! Për më tepër, një kartolinë me temë “60+: Fikni dritat dhe Ndizni idetë!” iu shpërnda gjithashtu të gjithë kolegëve, duke i ftuar ata të bëhen pjesë e kësaj ngjarjeje si një veprim solidariteti ndaj ndryshimeve klimatike!
- ◆ Dita Botërore e Mjedisit (WED) është dita më e rëndësishme për të nxitur rritjen e ndërgjegjësimin dhe veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit në mbarë botën. Intesa Sanpaolo Bank Albania, ashtu si çdo vit, e promovon këtë ditë të veçantë! Audiencia e synuar ishin të gjithë punonjësit dhe klientët që përdorin rrjetin e bankomatëve të bankës. Tema e këtij aktiviteti në vitin 2017 ishte “JAM ME NATYRËN!”.

ProCredit Bank Albania jep kontributin e vet në mjedis sidomos në lidhje me konsumin e energjisë, ujit, letrës dhe materialeve të tjera, transportit dhe gjendjes së pajisjeve dhe ndërtesës. Për sa i përket veprimtarive të saj, banka kontribuon gjithashtu në mënyrë të tërthortë te mjedisi nëpërmjet shërbimeve që ajo u ofron klientëve të saj (përfshirë këtu shërbimet bankare dhe financiare) dhe nëpërmjet shërbimeve dhe produkteve që konsumon nga furnitorë të jashtëm. Banka ka zhvilluar dhe zbatuar disa Politika Mjedisore. ProCredit Bank Albania synon të promovojë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm për mjedisin. Synimi është përmirësimi i performancës mjedisore të jashtme të bankës, duke projektuar dhe parashikuar shërbime të veçanta të kredive (Kreditë e Gjelbra) si për bizneset ashtu edhe për klientët individë, që ata të investojnë në efikasitetin e energjisë (EE), energjinë e rinovueshme (ER) dhe investime miqësore ndaj mjedisit. Për më tepër, ajo do të kontribuojë aktivisht për një mjedis më të pastër.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Mesazhi i ECO fashion SHOW, i mbështetur nga Raiffeisen Bank është “Të jetojmë si miq me mjedisin”. Qëllimet kryesore të këtyre aktiviteteve janë promovimi i vlerave dhe mbrojtja e mjedisit dhe natyrës.



OBJEKTIVI #15 Jeta në Stere

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA



Përdorimi i metodave inovatore financiare për të mbledhur fonde, me qëllim ruajtjen e pyjeve dhe ekosistemeve.

Promovimi i ndarjes sa më të drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike, dhe promovimi i aksesit së duhur në këto burime, në përputhje me standardet e vendosura dhe të miratuara në nivel ndërkombëtar.

Mobilizimi i rezervave nga të gjitha burimet dhe nivelet, për të financuar administrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ofrimin e stimujve të mjaftueshëm për vendet në zhvillim, për përparimin e një administrimi të tillë, duke përfshirë ruajtjen dhe pyllëzimin.



DREJTIMI PËRMESH SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania për “Ditën e Vullnetarizmit 2017” zgjodhi të mbështeste trashëgiminë kulturore të vendit dhe me 28 maj, 68 vullnetarë të bankës morën pjesë në pastrimin e Kalasë së Bashtovës nga barnat e dendura të këqija, që nuk i lejonte vizitorët të eksploronin muret e kalasë. Më 4 korrik, 20 vullnetarë nga degët e jugut ndihmuan një ekip të specializuar për të pastruar muret e Kalasë së Libohovës nga barnat e këqija, që rrezikonin shembjen e mureve. Kalaja e Libohovës u ndërtua në shekullin XVIII.

Punonjësit e **Bankës Amerikane të Investimeve** mbështetën nismën e Bashkisë së Tiranës për të pastruar mjedisin në Komunën e Farkës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania promovoi datën 22 maj, Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit! Gjithashtu ajo u shpërndau punonjësve një mesazh sensibilizimi për mbrojtjen e biodiversitetit nën moton e OKB-së për vitin 2017 :”Biodiversitet dhe turizëm i qëndrueshëm”; “Mbrojtja e biodiversitetit është në interesin tonë”! Burimet biologjike janë themelet mbi të cilat ne ndërtojmë qytetërimet”.

Punonjësit e **Procredit Bank** ndërmorën një fushatë pastrimi në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, në fillim të korrikut të vitit 2017.

Veneto Banka iu bashkua nismës së Bashkisë së Tiranës për përdorimin e biçikletave, duke mundësuar një kalim për biçikletat afër degës së saj te Kullat Binjake, Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë. Për një Tiranë më ekologjike!

OBJEKTIVI #16 Paqe dhe Drejtësi, institucione të forta

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunimi me investitorë të tjerë institucionalë për çështje të reja apo të diskutueshme, për promovimin e biznesit të përgjegjshëm në zonat me rrezik të lartë, duke siguruar që shoqëritë investuese të shohin një korrelacion të qartë mes biznesit të përgjegjshëm, di-sponueshmërisë, dhe çmimit të kapitalit.

Promovimi i shtetit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë.

Ulja thelbësore e korrupsionit dhe rryshfetit në të gjitha format e tyre. Sigurimi i vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet. Përhapja dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti:

- ◆ Organizimin e Konferencës së katërt “Sfidat e auditorëve në një mjedis ekonomik në ndryshim të vazhdueshëm”, organizuar me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Institutit Shqiptar të Auditorëve Statusor.

Konferenca u mbajt nga MODAV, në bashkëpunim me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, me temë: “Të auditosh për qëndrueshmëri dhe zhvillim”. Konferenca mbodhi së bashku përfaqësues kyç në fushën e auditimit në Shqipëri dhe Turqi, me synim identifikimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, si edhe nisjen e një mundësie bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti:

- ◆ Ditën Ndërkombëtare e PAQES! Motoja e vitit 2017 për këtë ditë ishte “Së bashku për Paqen: Respekt, Siguri dhe Dinjitet për të Gjithë”.
- ◆ Zyrën e Komisionarit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në aktivitetin e dedikuar Ditës Ndërkombëtare për Sigurinë në Internet më 10 shkurt 2017. Ky aktivitet ofroi një panoramë të plotë të situatës në Shqipëri, sidomos nëpërmjet sondazheve të rëndësishme të kryera me të rinjtë, që nxisin nevojën urgjente për shpërndarjen e informacioneve në të njëjtën kohë në të gjitha institucionet arsimore rreth sigurisë së të dhënave të tyre në mediat sociale dhe internet.



OBJEKTIVI #17 Partneritet për Objektivat

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Forcimi i lidhjes mes krijimit të vlerave të korporatave dhe shoqërisë dhe harmonizimi i strategjisë së krijimit të vlerës së organizatës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesëmarrja në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.

Zhvillimi i një sërë objektivash të industrisë së Shërbimeve Financiare të përafuara me OZHQ dhe harmonizimi i strategjisë së korporatave me ato qëllime, për optimizimin e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm.

Bashkëpunimi me shoqëritë e tjera të shërbimeve financiare dhe palët e interesit për të ofruar perspektiva të industrisë për qeveritë, politik bërësit, ligjvënësit dhe rregullatorët, mbi ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kuadrit ligjor, rregullator dhe tatimor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.

DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

American Investment Bank mbështeti Asambleenë e Përgjithshme të Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë. Banka ishte mbështetësi kryesor i kësaj veprimtarie, duke vazhduar të ofrojë mbështetjen e saj si institucion për investimet amerikane në vend, duke qenë vetë investitori më i madh amerikan në Shqipëri.

Për më tepër, për të dytin vit radhazi, banka ishte partneri kryesor i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë, duke organizuar një ceremoni festive me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara.

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti:

- ◆ Tryezën e Rrumbullakët Shqiptare në Forumin “Euromoney” për Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore: banka mbështeti dhe organizoi për të dytin vit radhazi Tryezën e Rrumbullakët Shqiptare “Progresi i Shqipërisë drejt rrugës për t’u bërë ekonomia me rritjen më të shpejtë në Ballkan për vitin 2017”, ku morën pjesë Ministri i Financave, z. Arben Ahmetaj, Zëvendës Guvernatorja e parë i Bankës së Shqipërisë, znj. Elisabeta Gjoni, Drejtori i Bankës Sea




Trade & Development, z. Ihsan Ugur Delikanli dhe Drejtori Ekzekutiv i BKT-së dhe Anëtari i Bordit, z. Seyhan Pencabligil.

- ◆ Forumin e Biznesit Bujqësor Shqipëri – Turqi: në kuadër të vizitës një-ditore në Shqipëri, Ministri i Ushqimit, Bujqësisë dhe Bagëtive H.E. Faruk ÇELİK morën pjesë në Forumin e Biznesit Bujqësor Shqipëri – Turqi. Në këtë forum morën pjesë disa sipërmarrës të këtij sektori nga të dyja vendet.
- ◆ Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO) me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërmjet dy vendeve dhe për të ndihmuar investitorët e huaj, duke sponsorizuar botimin e një fletëpalosje informuese për orientimin e investitorëve të huaj në Shqipëri.

Banka Credins mbështeti:

- ◆ Promovimin e konferencës për Zhvillimin e Agrobiznesit, të organizuar nga Dhoma Britanike e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri. Konferenca ndihmoi për një arsimit më të gjerë mbi potencialin e fushës së Bujqësisë në Shqipëri dhe promovoi gjithashtu investimin “Doing Business” dhe sipërmarrjet në këtë fushë.
- ◆ Konkursin Kombëtar “Ide të Gjelbra” i organizatës Partners Albania, i cili promovon sipërmarrjen, biznesin social, prodhimin vendas dhe punësimin. Banka i dha një çmim projektit “Terapia e Aromave”, një ndërmarrje e re që nxit prodhimin vendas nëpërmjet përpunimit të vajrave esenciale.
- ◆ Institucione të ndryshme, si: Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke ofruar lehtësi për shërbimet dhe solidaritet me pensionistët, nëpërmjet një pakete me shërbime dhe mallra falas, në kuadër të mbështetjes dhe përkujdesjes për këtë kategori. Veç kësaj, Banka ofroi llogari dhe kredi me komision zero për studentët që marrin bursë nga bashkitë.
- ◆ Banka bashkëpunoi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të vënë në jetë platformën e-Albania, duke lehtësuar procesin e integruar të pagesave në të gjitha platformat e institucioneve publike, përfshirë këtu: Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Policinë e Shtetit dhe atë Bashkiake, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), etj.
- ◆ Aktivitetet dhe veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare, me rastin e festave tona kombëtare më 28 dhe 29 nëntor, nëpërmjet institucioneve si: Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shkup, Maqedoni, Shoqata për Zhvillimin e Kulturës dhe Artit “Kongresi i Alfabetit”





në Bitola, Maqedoni dhe Shoqata Kulturore dhe Artistike “Iliria”.

Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- ◆ 26 prill – Dita e Zojës së Këshillit të Mirë, ku të gjithë studentët italianë në Shqipëri dhe figurat kryesore të politikës dhe ekonomisë u bashkuan për të festuar krijimin e mundësive për bashkëpunime të reja dhe për të promovuar shkëmbimet kulturore dhe përfitimet nga niveli evropian i arsimit që ofrohet në institucionin e tyre, që u jep mundësi të gjithë studentëve të tyre shqiptarë të vazhdojnë studimet e mëtejshme në Itali dhe të përgatiten për tregun ndërkombëtar të punës.
- ◆ Banka mbështeti Ambasadën Italiane për të organizuar aktivitetin e 2 qershorit, Ditës së Republikës së Italisë, të zhvilluar në rezidencën e Ambasadorit. Kjo ishte gjithashtu një mundësi e mirë për të krijuar bashkëpunime të reja në fushën e zhvillimit të ekonomisë, pasi ky aktivitet pati një pjesëmarrje të konsiderueshme të bizneseve të suksesshme në vend.
- ◆ 27 shtator, Dita Botërore e Turizmit! Një mundësi e veçantë për të rritur sensibilizimin mbi kontributin e turizmit të qëndrueshëm për zhvillimin ndërmjet vendimarrësve në sektorin publik dhe privat dhe të gjitha palëve të interesit. Në këtë ditë, Intesa Sanpaolo Bank Albania rriti ndërgjegjësimin e të gjithë punonjësve nëpërmjet kartolinave të personalizuar me moton:
A je një udhëtar i përgjegjshëm?
Në këtë Ditë Botërore të Turizmit, kurdo të udhëtosh, kudo të udhëtosh, kujtohu:
TË RESPEKTOSH NATYRËN, TË RESPEKTOSH KULTURËN DHE TË RESPEKTOSH MIKËPRITISIT.
UDHËTO, SHIJO DHE RESPEKTO!
- ◆ Dha kontributin e saj për Aktivitetin e Fund vitit si anëtar i Confindustria Albania, ku u mbledhën bizneset italiane dhe shqiptare, me praninë e përfaqësuesve të rëndësishëm politikë dhe ekonomikë, duke krijuar bashkëpunime dhe duke u kujdesur për marrëdhëniet e tyre për një ekonomi më të lulëzuar.
- ◆ Banka ka punuar vazhdimisht në rritjen e ndërgjegjësimit për QZHQ-të duke i promovuar ato gjatë vitit 2017. Duke filluar nga nëntori i vitit 2015, si banka e parë në sistemin bankar shqiptar që mbështeti Objektivat e Mijëvjeçarit me një mendim të qartë për të ardhmen, banka shpalli disa thirrje për veprim (duke promovuar kalendarin e OKB-së) për punonjësit dhe klientët në disa ditë të veçanta me moton: “Është koha të ndryshojmë botën! Thuaja të gjithëve!”. Intesa Sanpaolo Bank Alba-



nia iu bashkua përpjekjeve të grupit Intesa Sanpaolo për të ofruar shërbime cilësore bankare dhe financiare për klientët e saj dhe përdori disa mënyra për të promovuar zhvillimin e të gjitha zonave ku operon banka. Ajo beson se zgjedhjet e duhura për shoqërinë dhe mjedisin janë edhe zgjedhje fitimtare nga ana ekonomike. Me marrjen e përgjegjësisë për menaxhimin e kujdesshëm të kursimeve, banka vazhdon të jetë e angazhuar për zgjerimin e qasjes ndaj kredive dhe instrumenteve financiare për të gjithë, dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit sipërmarrës. Vendimet e bankës kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në mjedisin natyror dhe në komunitet. Për të ofruar shërbimet e saj më të mira për të gjitha palët, banka udhëhiqet nga Kodi i Etikës, i cili përbën një instrument qeverisjeve dhe është pjesë e një vizioni më të gjerë të përgjegjësisë sociale dhe mjedisore të bankës, duke i dhënë rëndësi parësore marrëdhënieve me palët e interesuara.

AAB-ja ka trajtuar çështje të rëndësishme rregullatore që ndikojnë në veprimtarinë e sektorit bankar.

Udhëzimi për Tarifat e Përmbauesit Privat - pas ndryshimeve të bëra në vitin 2016 në Kodin e Procedurës Civile, ku ndër të tjera u prezantua koncepti i tarifës së suksesit për përmbauesin, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave nxorën udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28/6/2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbaues gjyqësor privat". Njëpërmjet organeve zbatuese, AAB-ja ka kundërshtuar fort këtë udhëzim dhe sidomos tarifën e larta që ai përcakton, veçanërisht ato fikse, të cilat në përfundim do t'i ngarkohen debitorit. Shqetësimet e sektorit bankar iu paraqitën gjatë vitit 2017 institucioneve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, si Kryeministrit, Ministrin të Drejtësisë, Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Problematikat fiskale në lidhje me bankat - gjatë vitit 2017, sekretariati i AAB-së dhe komitetet teknike të saj kanë diskutuar gjerësisht mbi nevojën për ndryshimin e kuadrin ligjor fiskal me synimin për të pasur akte rregullatore më të mira dhe më të hollësishme, në përputhje me praktikën më të mira të BE-së dhe vendeve të rajonit. AAB-ja kontraktoi PricewaterhouseCoopers Albania (PwC), si këshilltar për përgatitjen përfundimtare të ndryshimeve të propozuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, sidomos në lidhje me trajtimin e tatimit mbi kapitalin dhe ri posedimin e tij. Propozimet përkatëse iu paraqitën Ministrin të Financave. Lidhur me këtë çështje, përfaqësuesit e AAB-së organizuan disa takime me përfaqësuesit përkatës të këtyre autoriteteve.



2017

RTNERËT SHQIPËRI
NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Thirrje për aplikim



Mëshkëlur nga:



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Banka Kombëtare Tregtare i konsideron punonjësit si partnerë në suksesin e saj. Mjedisi dhe atmosfera e punës shihen si një nga faktorët kyç të suksesit të një organizate. Për të mbështetur këtë ide, Banka Kombëtare Tregtare financoi një udhëtim turistik për punonjësit e Entit Kombëtar të Banesave.

Ditët e Studimeve Shqiptare

Mbështetur nga First Investment Bank Albania

Çdo vit, Universiteti Evropian i Tiranës organizon gjatë muajt prill, konferenca të ndryshme lidhur me Studimet Shqiptare që titullohen “Ditët e Studimeve Shqiptare”, i cili është projekti vjetor më i madh i UET-së dhe në vitin 2017, ky projekt shënoi edicionin e tij të katërt. Kjo ngjarje sjell së bashku kërkuesit shkencorë vendas dhe të huaj, profesorë dhe personalitete të larta, të cilët mblidhen për diskutime në tryeza të rumbullakëta dhe debatojnë brenda kuadrit të “Strategjisë së Kërkimit Shkencor të UET-së për vitet 2015-2020”. Tema e këtij viti ishte: “Rimodelimi i reformave për një model të ri të rritjes ekonomike dhe zhvillimit social”. Në këtë kuadër, FIBank Albania u përfaqësua nga Drejtori i saj Ekzekutiv, z. Bozhidar Todorov si i ftuar nderi. Z. Todorov foli për problematikat në sektorin bankar që lidhen me krizën pas vitit 2008. Veç kësaj, ai e përshkroi ndikimin e krizës në Shqipëri dhe masat e marra për të parandaluar që kjo situatë të prekë tregun vendas. Kjo nismë arsimore me UET-në do të vazhdojë deri në vitin 2020.

Société Générale Albania mbështeti:

- ◆ Forumin e tretë ekonomik frankofon. Ky forum është një nga ngjarjet kryesore të Pranverës së Frankofonisë.
- ◆ Festivalin ZA të organizuar më 26 gusht, në Theth. Një aktivitet artistik krejt ndryshe nga ato që jemi mësuar të shohim.
- ◆ Premierën botërore të “Trait D’union & Creation 2017” në Shqipëri, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze.

Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut , hartimi i agjendës 2018, projekti “Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut”

Duke pasur parasysh që viti 2018 është shpallur “Viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut”, Ministria e Diasporës u përfshi në projektin madhor të qeverisë, duke prodhuar postera, agjenda dhe kalendarë me simbolet tona kombëtare. Për të mbështetur këtë projekt të rëndësishëm, **Tirana Bank** sponsorizoi prodhimin e 1,350 agjendave.

ART, SPORT & KULTURË

Alpha Bank Albania mbështeti:

- ◆ Edicionin e pestë të Festivalit të Kitarës të organizuar nga Fondacioni "Guitar Foundation Albania".
- ◆ Aktivitetin Mikis Theodorakis. Një koncert të organizuar për nder të kompozitorit grek Mikis Theodorakis.
- ◆ Rikonstrukcionin e ndërtesës historike "Seferis" në Korçë. Kjo ndërtesë i përkiste nobelistit Jorgos Seferis, i cili ka shërbyer për dy vite si Konsull në qytetin e Korçës dhe gjatë kësaj periudhe ai përforcoi marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- ◆ Ekipin e Basketbollit për femra "Flamurtari: në Vlorë, i cili ishte shpallur fitues i kampionatit kombëtar të basketbollit për femra në muajin maj.
- ◆ Ekipin sportiv të Klubit Sportiv "Studenti"
- ◆ Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Klubin Sportiv "Studenti", inicioi organizimin e seancave sportive në qendrën sociale të Tiranës.
- ◆ Teatrin "Ferma e Kafshëve" në Teatrin Kombëtar Eksperimental.
- ◆ Qendra Kulturore e Tiranës ("Teatri Metropolitan") – Komedia "39 Hapat" premiera e së cilës u vu në skenë në Shqipëri dh në Ballkan në këtë teatër.
- ◆ Të gjitha ekipet sportive të Klubit Sportiv "Studenti".
- ◆ "Motofest 2017", 23 dhe 24 qershor.
- ◆ Aktivitetin e Bienales "Mediterranea 18", e organizuar nga Ministria e Kulturës për herë të parë në vendin tonë në datat 4-9 maj.
- ◆ Kryeveprat e artit italian në viteve 1900 në Galerinë Kombëtare të Arteve.
- ◆ Muzeun "Ento Vibe" të organizuar nga Instituti Ti dhe Ministria e Kulturës, në kuadër të Ditës Kombëtare së Trashëgimisë Kulturore.
- ◆ Kryeveprën botërore të "Ferma e Kafshëve" të George Orwell në Teatrin Kombëtar Eksperimental. Pas një muaji shfaqesh në vëna në skenë në Tiranë, trupa e artistëve vijoi rrugëtimin në qytete të tjera kryesore të vendit.
- ◆ Grupi muzikor Jericho që këtë vit festoi përvjetorin e 20-të të krijimit zhvilloi një koncert në datën 26 dhjetor 2017 te Piramida, e organizuar nga Qendra Kulturore TULLA për turin e albumit të tyre të ri "Oborri".
- ◆ Komedia "Çfarë do të bëhem kur të rritem?" e vënë në skenë në mjediset e Teatrit Kombëtar.
- ◆ "Rojat e Taxhit", një bashkëpunim mes Shoqatës BASH Art dhe Teatrit Eksperimental "Kujtim Spahivogli".






Banka Kombëtare Tregtare mbështeti Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Ankara: për organizimin e aktivitetit me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, 28 nëntor.

Banka Credins sponsorizoi:

- ◆ Institutin TI dhe Muzeun Historik për aktivitetin “Etno Vibe Style Museum” Është aktiviteti i parë në llojin e tij që promovon stilin bashkëkohor sipas traditës, me rastin e Ditës së Trashëgimisë Kulturore Shqiptare më 29 shtator 2017. Banka e promovoi këtë iniciativë që kontribuon në integrimin e brezave të rinj shqiptar në etnografinë dhe identitetin shqiptar, si dhe në dimensionet e saj moderne.
- ◆ Federatën Shqiptare të Basketbollit. Banka vazhdon të ofrojë mbështetjen e saj me pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror të Basketbollit për Meshkuj 2019. Një tjetër institucion që Banka Credins ka ndihmuar është Klubi Multi-Sportiv i Tiranës, duke mbuluar kostot e rindërtimit të këtij klubi.
- ◆ Universitetin e Arteve, përmes sponsorizimit të aktivitetit kushtuar 100 vjetorit të lindjes së kompozitorit të madh shqiptar, Prenk Jakova. Teatri i Operës dhe Baletit e shpalli vitin 2017 si vitin e kompozitorit Prenk Jakova, për ky vit përkon me 100 vjetorit të lindjes së tij. Banka ka qenë gjithmonë partnere dhe bashkëpunëtore në pothuajse të gjitha iniciativat që promovojnë artin shqiptar.



NGB Bank Albania

- ◆ Ishte Sponsor Gjeneral i shfaqjes teatrale të titulluar “Zonja me Kamelian”, bazuar në romanin e njohur të Alexander Dumas.
- ◆ Mbështeti një produksion bashkëkohor baleti të vënë në skenë nga Eltion Merja dhe Rovena Dilo, me titull “Upside Down”.
- ◆ Sponsorizoi koncertin e orkestrës Mikis Teodorakis.

Tirana Bank:

- ◆ Sponsorizoi Ditën e Verës të organizuar nga Convivium Slow Food Përmet dhe Bashkia e Përmetit në këtë qytet.
- ◆ Drejtoria Arsimore Rajonale e Lezhës organizoi me mbështetjen e Tirana Bank, festën e 7 marsit në ambientet e Pallatit të Kulturës së Qytetit, ku ishin të pranishëm mësues dhe studentë nga e gjithë qarku i Lezhës.
- ◆ Ishte sponsor gjeneral i festimeve të Ditës Kombëtare të Greqisë, të organizuar nga Ambasada Greke në Tiranë.
- ◆ Festoi Ditën e Liqenit dhe hapjen e sezonit turistik në Pogradec.
- ◆ Për të dytin vit radhazi, ofroi mbështetje për Federatën



Badminton, të organizuar në muajin qershor në qytetin e Korçës.

- ◆ Ishte sponsori kryesor i koncertit “Maratona e Këngës”, e organizuar në qendër të qytetit të Shkodrës më 17 gusht, në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës.
- ◆ Sponsorizoi Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në organizimin e një aktiviteti kulturor dy-ditor, më 17 dhe 18 nëntor 2017 në Tiranë, në nder të kompozitorit të famshëm grek Mikis Theodorakis.

Veneto Banka ishte e pranishme në veprimtarinë e organizuar nga Ambasada Italiane me rastin e 71 vjetorit të festës së Republikës së Italisë.

Union Bank është sponsori zyrtar i ekipit kombëtar të futbollit, duke e mbështetur këtë ekip në të gjitha sfidat dhe garat ku merr pjesë. Përmes këtij bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit, Union Bank mbështet jo vetëm ekipin kombëtar, por gjithashtu nxit edhe zhvillimin e futbollit dhe sporteve në tërësi në vendin tonë.

Gjithashtu, për një jetë të shëndetshme dhe për më shumë mirëqenie me aktivitete fizike, Union Bank mbështeti pjesëmarrjen e ekipeve të stafit të saj në ndeshjet e volejbollit dhe futbollit amator.



ÇMIME

Banka Kombëtare Tregtare

Gjatë 2017, Banka Kombëtare Tregtare u nderua me çmimin Banka më e Mirë në Shqipëri nga vlerësuesit më prestigjioz financiar:

AAA (Alb) në Shkallën Kombëtare Afatgjatë – JCR Euroasia Rating

Në qershor 2017, Banka Kombëtare Tregtare u vlerësua në Shkallën Kombëtare Afatgjatë me AAA (Alb) për të nëntin vit radhazi nga JCR Euroasia Rating, duke konfirmuar sërish kategorinë e nivelit të lartë të investimeve bashkë me vlerësimin “E qëndrueshme”. Gjithashtu, klasifikimi në Shkallë Afatgjatë i Monedhës Lokale dhe të Huaj Ndërkombëtare u konfirmua edhe për nivelin “BBB” të shkallës së investimeve, një nivel më lart se niveli kufi i vendeve, së bashku me vlerësimin “E qëndrueshme”.

Banka më e Mirë në Shqipëri – Emea Finance & Euromoney

Në qershor 2017, Banka Kombëtare Tregtare u vlerësua edhe një herë me çmimin “Banka më e Mirë Lokale në Shqipëri në 2016” nga revista prestigjioze financiare britanike “EMEA Finance” për të shtatën herë. Në korrik 2017, Banka Kombëtare Tregtare vazhdon të kryesojë në tregun bankar shqiptar, duke marrë çmimin “Banka më e Mirë në Shqipëri” nga EUROMONEY për të gjashtin vit radhazi.

Banka e vitit në Shqipëri për vitin 2017 – The Banker

Në nëntor 2017, Banka Kombëtare Tregtare u përzgjedh si “Banka e vitit në Shqipëri” për herë të tretë, duke treguar edhe një herë suksesin e saj në marrjen e këtij çmimi nga revista “The Banker” për “Çmimet e Bankës së vitit 2017”, një botim i “Financial Times”. Kjo është hera e tetë që BKT nderohet me këtë çmim prestigjioz në fushën e shërbimeve financiare. Ceremonia u zhvillua në Londër më 29 nëntor 2017.



Banka Credins u nderua me një çmim të veçantë si donatore që i kushton vëmendje jetës dhe edukimit të fëmijëve, duke kontribuar nëpërmjet mbështetjes së qëndrueshme dhe në mënyrë specifike, duke mbuluar shpenzimet e tre fëmijëve të fshatit SOS dhe duke nxitur fuqizimin e mëtejshëm të “Fshatrave SOS për Fëmijët Shqiptar” me ofrimin e mundësive më të mëdha dhe me investimin në një shtëpi të lumtur në Shqipëri.

Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB)

Në ditën e donatorëve të organizuar nga fshati SOS, banka u nderua me një çmim si një donatore e rregullt e fshatit SOS dhe për kontributin e dhënë gjatë kësaj periudhe 7 vjeçare.

